

Aneksi 1 – Perkufizime

Shprehjet e meposhtme do te kene kuptimet e meposhtme ne kete Marreveshje pervecse kur konteksti e nenkupton ndryshe :

Shqiperi	quhet Republika e Shqiperise;
Arrij	quhet ne lidhje me (a) cdo Test, qe Kriteri i Suksesit te Testit ne lidhje me kete Test eshte permbushur dhe (b) ne lidhje me cdo Objektiv, qe ngjarja ose detyra ne lidhje me kete Objektiv eshte permbushur,dhe “ Arritur ” do te kete kete kuptim;
Filial	Do te quhet cdo organ i ndervarur i shoqerive tregtare,, cdo ent tjeter i cili Kontrollon direkt ose indirekt, Kontrollohet, ose eshte nen kontroll te perbashket direkt ose indirekt me ate organ te korporuar here pas here;
Marreveshje	quhen Nenet e kesaj marreveshje se bashku me Anekset dhe shtojcat e saj dhe cdo document qe I referohet ose qe i bashkengjitet;
Vit i Marreveshjes	quhet periudha prej dymbedhjete (12) muajsh qe fillon me daten e Hyrjes ne Fuqi ose ne peryjetorin e Dates se Hyrjes ne Fuqi;
Shkelje e Autoritetit	quhet cdo shkelje nga ana e Autoritetit te detyrimeve te shprehura te Autoritetit sipas kesaj Marreveshje (pervecse kur jane shkaktuar ose kontribuar nga Koncesioneri ose si pasoje e ndonje veprimi ose mosveprimi nga Autoriteti te cilil Koncessionari i ka dhene miratim paraprak);
Te dhenat e Autoritetit	quhen te dhenat, tekste, vizatime, diagrama, imazhe (se bashku me cdo baze te dhenash te krijuar prej tyre) te cilat jane trupezuar ne cdo media elektronike, magnetike, optike ose te prekshme, dhe qe jane:

	<p>(a) siguruar nga Koncesioneri nga ose per llogari te Autoritetit; ose</p> <p>(b) te cilat Koncesionerit i kerkohet t'i prodhoje, perpunoje, ruaje ose transmetoje ne perputhje me kete Marreveshje;</p>
Pergjegjesite e Autoritetit	quhen pergjegjesite e Autoritetit te specifikuara ne Aneksin 8;
Perfaqesuesi i Autoritetit	quhet perfaqesuesi i emeruar nga Autoriteti ne perputhje me Nenin 19.2;
Banka	quhet banka qe ekzekuton Garancine e Performances ;
Vazhdimesia e Biznesit	Quhet veprimtari e vazhdueshme e Sherbimeve te Koncesionerit sipas kesaj Marreveshje pa nderprerje ne rast te Moskryerjes se Sherbimit ose ndonje problemi tjeter si ngjarja e nje Force Madhore dhe cdo lloj aktiviteti kriminal;
Plani i Vazhdimesise se Biznesit	quhet plani qe percakton proceset dhe marrveshjet te cilat Koncesioneri do t'i zbatoje dhe ndjeke ne lidhje me Planin e Vazhdimesise se Biznesit se Sherbimeve ;
Manuali i Procesit te Biznesit	quhet dokumentitet qe do te pergaqitet dhe mbahet nga Koncesioneri dhe qe detajon proceset dhe procedurat e perdonura nga Koncesioneri per sigurimin e sherbimeve te detajuara ne Aneksin 22;
Vendndodhja e Qendrore e Prodhimit	quhet PCC;
Sistemi Qendror i Monitorimit te Gjurmeve dhe Shenjave	quhet baza e te dhenave e cila ruan te dhena mbi Pullat Fiskale ne perputhje me Kerkesat, Zgjidhjen dhe kushte te tjera te percaktuara ne

	kete Marreveshje;
Ndryshim	quhet cdo ndryshim ne kete Marreveshje ;
Shenim per Ndryshimin e Autorizimit	quhet forma e perdonur nga Palet per te percaktuar nje Marreveshje Ndryshimi te percaktuar e cila do te kete formen e percaktuar ne Shtojcen 3 te Aneksit 16;
Komunikimi i Ndryshimit	quhet cdo Kerkese Ndryshimi, Vleresim Impakti, Shenim per Ndryshimin e Autorizimit ose komunikim tjeter i derguar ose i kerkuar epr tu derguar ne perputhje me Aneksin 16;
Procedura e Ndryshimit te Kontrollit	quhet procedura per ndryshimin e kesaj Marreveshje, sic eshte percaktuar ne Aneksin 16;
Ndryshimi i Kontrollit	nenkupton se HoldCo pushon se kontrolluari Koncesionerin. Per shmangjen e dyshimit, asnje transferim i te teres ose i nje pjese te pronesise ose interesit ne menaxhimin nga Koncesioneri tek ndonje person ose entitetet te kontrolluar ose nen kontroll te perbashket me Koncesionerin do te perbeje nje Ndryshim Kontrolli sipas kesaj Marreveshje;
Kerkesa e Ndryshimit	quhet kerkesa me shkrim per nje Ndryshim te Marreveshjes qe do te kete kryesisht formen ne Shtojcen 1 te Aneksit 16;
Detyrime	quhen detyrimet e pagueshme nga Autoriteti per Koncesionerin per kryerjen e Sherbimeve ne perputhje me kete Marreveshje duke perfshire cdo kosto dhe shpenzim te pagueshem dhe cdo detyrim dhe rregullim te atyre detyrimeve te percaktuara ne Nenin 17 dhe Anekset 11 dhe 18 dhe kudo ne kete Marreveshje ;
Njesite e kompjuterit ose Skanerat Sicpamobile	quhen njesite e kompjuterave te dores (handheld) te perdonur nga Koncesioneri ne

	perputhje me Kerkesat dhe kushtet e tjera te kesaj Marreveshje per perdorim nga Perdoruesit e Fundit dhe stafi per te monitoruar dhe vleresuar produktet qe mbajne pullat fiskale fillimisht versioni Sicpamobile SM04;
Koncesion	quhet financimi, dizenjimi, prodhimi dhe ngritura e nje Sistemi per emetimin dhe shperndarjen e Pullave Fiskale dhe sherbime te tjera te percaktuara ne kete Marreveshje;
Tarifa e Koncesionit	quhet tarifa qe i i eshte paguar Autoritetit nga Koncesioneri ne perputhje me Aneksin 18, dhe kjo tarife do te rregullohet ne perputhje me Aneksin 11;
Koncesioneri	quhet (a) Kompania Meme ne dhe duke perfshire Daten e Nenshkrimit deri, por duke perjashtuar, Daten e Nenshkrimit, dhe (b) SICPA Albania ne dhe pas Dates se Nenshkrimit;
Paisjet Koncesionere	quhen hardware, printerat, paisjet e sigurise, paisjet kompjuterike dhe mjete e pajisje te telekomit te perdorur nga Koncesioneri ose Nenkontraktuesit e tij per sigurimin e Sherbimeve ;
Software i Koncesionerit	quhet Software i cili eshte ne pronesi te Koncesionerit, duke perfshire software qe perdoret apo do te perdoret nga Koncesioneri per qellimin e sigurimit te Sherbimeve;
Stafi i Koncesionerit	quhen te gjithe punonjesit, agjentet, konsulentet dhe kontraktoret e Koncesionerit dhe/ose te ndonje Nenkontraktori;
Testet e Koncesionerit	quhen ato procedura testimi qe do te ndermerren nga Koncesioneri ne perputhje me Aneksin 6 perpara Procedurave te Testimit;
E Drejta e Pronesise Intelektuale te	quhet:

Koncesionerit (DPI)	<p>(a) DPI-ja e zoteruar nga Koncesioneri perpara Dates se Hyrjes ne Fuqi, per shembull ato qe konsistojne ne mjetet standarte te zhvillimit te Koncesionerit , komponentet e programit ose kode standarte te perdorur ne programimin e kompjuterave ose ne median fizike ose elekronike qe permban Know-How/Njohuri te Koncesionerit ose metodologjite e pergjithshme te biznesit; dhe/ose</p> <p>(b) DPI-te e krijuara nga Koncesioneri jashte kesaj Marrevshje, por duke perjashtuar DPI-te e zoteruara nga Koncesioneri qe konsistojne ne Softwarin e Koncesionerit;</p>
Perfaqesuesi i Koncesionerit	quhet perfaqesuesi i caktuar nga Koncesioneri ne perputhje me Nenin 19.1;
Informacioni Konfidencial	quhet cdo informacion, sido qe te jetë percuar , qe lidhet me biznesin, punet, zhvillimet, sekretet tregtare, Know-How, Stafin dhe furnitoret e nje Pale, duke perfshire DPI-te, se bashku me te gjithe informacionin e percaktuar me siper, dhe cdo informacion tjeter qe eshte percaktuar qarte se eshte konfidencial (pavaresisht nese shenon apo jo “konfidencial”) ose qe duhet konsideruar llogjikisht si konfidencial;
Kontrolli	quhet se nje person zoteron, direct ose terthorazi, kompetencen te drejtoje ose ndikoje ne orientimin e menaxhimit dhe politikave te personit tjeter (qofte me anen e zoterimit te aksioneve me te drejte vote , me kontrate ose forme tjeter) dhe “ Kontrollon ” dhe“ I Kontrolluar ” do te interpretohen perkatesisht ne perputhje me kete;

Plani i Korrigjimit	quhet plani i Koncesionerit per rregullimin e cdo mos-perputhje ne ndonje prej Mallrave dhe cdo lloj deshtimi tjeter ne sigurimin e Sherbimeve ne perputhje me afatet dhe kushtet e kesaj Marreveshje;
Moskryerje Kritike e Sherbimit	quhet, ne lidhje me cdo deshtim/moskryerje qe kerkon mirembajtje korrigjuese(a) Nivel i Rendesise qe i eshte percaktuar kerkeses se sherbimit perkates ne perputhje me Seksionin 4 te Aneksit 5 eshte Rendesiai 1 dhe (b) ky deshtim/moskryerje vazhdon pa u rikuperuar per dy ose me shume Dite Pune te njepasnjeshme pasi Koncesionari ka marre kete kerkeze;
Ngjarje Monedhe	quhet venia e cdo kufizimi ne Republiken e Shqiperise (duke perfshire kufizimet sipas cdo rregullore te shkembimit te monedhes se huaj) qe ben qe Autoriteti ose ndonje Prodhues te mos kene mundesine per te kryer pagesa sipas kesaj Marreveshje ne Euro per Koncesionerin ne perputhje me Aneksin 25, ose qe shkakton pamundesi per te transferuar fonde ne Euro ne llogarine bankare te Konccesionerit, te specifikuar ne cdo fature te leshuar nga Koncesioenri ne perputhje me Aneksin 25.
Legjislacioni i Mbrojtjes se te Dhenave	quhet Ligji Nr. 9887, date 10.03.2008 “Mbi Mbrojtjen e te Dhenave Personale”;
Mospermbushje	quhet cdo shkelje e detyrimeve te Pales perkatese (duke perfshire por jo duke u kufizuar ne shkeljet thelbesore ose shkeljet e nje afati thelbesor) ose ndonje mospermbushje tjeter , veprim, mosveprim, neglighence ose gjendje e Pales perkatese, punonjesve te saj, kryresve te sherbimit,, agjenteve ose nenkontraktuesve ne lidhje me objektin e kesaj Marrveshje, e cila nuk ka ardhur per shkak te Forces Madhore dhe ne

	lidhje me kete kjo Pale eshte perjegjese ndaj pales tjeter;
Defekt	<p>quhet:</p> <p>(a) cdo gabim, dem ose defekt ne prodhimin e nje Malli ;</p> <p>(b) cdo gabim ose mosfunkcionim i kodit ne softwarit e Koncesionerit, softwarin e Pales se Trete ose Softwari i shkruar specifisht i cili i shkakton nje Malli keqfunkcionim ose i shkakton prodhimin e rezultatave te pakuptueshme dhe te pasakta;</p> <p>(c) cdo deshtim i cdo Malli per te patur rendimentin , vecorite dhe funksionalitetin e specifikuar tek Kerkesat ose Zgjidhja; ose</p> <p>(d) cdo deshtim i cdo Malli per te funksionuar ne lidhje me ose te nderveproje me cdo Malli tjeter ne menyre qe te siguroje rendimentin , vecorite dhe funksionalitetin e specifikuar tek Kerkesat ose Zgjidhja;;</p>
Vonesa	quhet periudha e kohes gjate se ciles zbatimi i Sherbimeve ne lidhje me Zbatimin e Planit eshte vonuar si pasoje e nje deshtimi per te Arritur nje Objektiv;
Pagesa Vonesë	quhen shumat e pagueshme nga Koncesioneri per Autoritetin ne lidhje me nje Vonesë sikunder eshte e specifikuar ne Aneksin 11;
Mallra	quhet nje njesi, vecori ose sherbim i lidhur me sigurimin e Sherbimeve ose nje ndryshim ne sigurimin e sherbimeve qe kerkohet te shperndahet nga Koncesioneri ne nje Date te Shenjestruar/Date Objektiv ose nje nje faze tjeter gjate zbatimit te kesaj Marrevshje;

Dizenjo	quhen dizenjot per Pulla Fiskale per te cilat eshte rene dakort midis pales per perdonim tek produktet alkolike, produktet e duhanit dhe, ne baze te nenit 3.6 te kesaj Marreveshje, edhe produkte shtese sipas kerkeses se Autoritetit dhe per te cilat Koncesioneri ka rene dakort ;
Qendra e Rikuperimit te Shkatterimeve	quhet vendndodhja e percaktuar ne Aneksin 23 dhe ne Planin e Vazhdimesise se Biznesit ku Koncesioneri do te siguroje rikuperimin e Sherbimeve, Sistemit dhe mbeshtetjen per Sistemin e Monitorimit te Gjurmeve dhe Shenjave ne rastin e nje gjendje qe e ben vendodhjen kryesore per Sistemin Qendor te Monitorimit te Gjurmeve dhe Shenjave te paperdorshem;
Mosmarreveshjet	quhet cdo mosmarreveshje, ndryshim ose ceshtje interpretimi qe lind nga kjo Marreveshje , duke perfshire cdo mosmarrevshje, ndryshim ose ceshtje interpretimi ne lidhje me Sherbimet, mos renia dakort mbi Proceduren e Ndryshimit te Kontrollit dhe cdo ceshtje tjeter ku kjo Marreveshje i drejton Palet te zgjidhin nje ceshtje duke iu referuar Procedures se Zgjidhjes se Mosmarrveshjeve;
Procedura e Zgjidhjes se Mosmarreveshjeve	quhet procedura e zgjidhjes se mosmarrevshjeve te percaktuara ne Aneksin 15;
Sistemi i shperndarjes	quhet nje pjese e Paisjes Koncesionere e instaluar ne keto ambiente ose ne keto vende, sikunder Koncesioneri mund, me diskrecionin e vet, te zgjedhe ose percaktoje kohe pas kohe ne perputhje me kete Marreveshje e cila lejon gjurmimin e dergimit dhe marrjes se Pullave Fiskale te cilat mund te perbehen ngakomponentet e meposhtem: (i) Njesite Kompjuterike; dhe

	<p>(ii) nje ose me shume kompjutera me softwarin e nevojshem per te drejtuar Sistemin dhe per te komunikuar me Sistemin e Monitorimit te Gjurmave dhe Shenjave;</p>
Dokumentacioni	<p>quhet pershkrimi i Sherbimeve dhe Nivelit te Sherbimeve, specifikimeve teknike, manualeve te perdorimit, manualeve te veprimit, percaktimit te procesit dhe procedurave, dhe te gjithe dokumentacioent e tjera sic:</p> <ul style="list-style-type: none"> (a) kerkohet te furnizohet Autoriteti nga ana e Koncesionerit sipas kesaj Marrrveshjeje; (b) sic kerkohet nga Koncesioneri ne menyre qe te siguroje Sherbimet; ose (c) eshte ose do te gjenerohet per qellimin e sigurimit te Sherbimeve;
Data e Hyrjes ne Fuqi	quhet data e pare ne te cilen seicili prej kushteve te percaktuara ne Nenin 4.1 te kesaj Marreveshje jane permbushur ;
Perdoruesi Fundor	cdo person i autorizuar nga Autoriteti per te perdorur Sistemin, Sistemin Qendror te Monitorimit te Gjurmave dhe Shenjave, Njesite Komputerike dhe/ose Sherbimet Operacionale si inspektor taksash apo ndonje Ent Shteteror tjeter;
Procesi i Pershkallezimit	quhet fazë fillestare e procesit qe merret me Mosmarreveshjet pa nderhyrjen e paleve te treta sic eshte percaktuar ne Paragrafin 2 te Aneksit 15;
Euro	quhet njesia monetare zyrtare e vendeve anetare te Bashkimit European te cilat kane pranuar Bashkimin Monetar European;
Data e Nenshkrimit	quhet data e pare ne te cilen kjo Marreveshje

	eshte nenshkruar nga palet;
Menaxhimi Dales	quhen detyrimet dhe te drejtat e percaktuara ne Aneksin 22;
Periudha Dalese	<p>quhet periudha qe fillon me pare se :</p> <p>(a) gjashte (6) muaj perpara skadimit te kesaj Marreveshje; ose</p> <p>(b) Koncesionari ne menyre te vlefshme jep ose merr njoftim per perfundimin ne perputhje me dispozitat e kesaj Marreveshje ,</p> <p>dhe, kur eshte e zbatueshme, qe perfundon ne daten e Transferimit te Sherbimeve, por jo me vone se ne perfundim te Afatit;</p>
Plani i Daljes	quhet plani, i cili do te bazohet ne permbytjen e Aneksit 22, e qe do te miratohet nga Palet, I cili do te percaktoje detyrimet e cdo Pale ne detaje ne menyre qe te siguroje nej transferim normal dhe eficent te Sherbimeve si tek Autoriteti dhe/ose ndonje Koncesioner Zevendesues.;
Gadishmeria e Fabrikes	do te kete kuptimin qe i eshte dhene ketij termi ne Nenin 38.3 te kesaj Marrevshje;
Data e Gadishmerise se Fabrikes	quhet data ne te cilin te gjithe (por nje) Prodhucesit e Shkalles se Gjere kane marre Gadishmerine e Fabrikes;
Ndryshimet e shpejta	quhet cdo Ndryshim per te cilin palet bien dakort te shpejtojne ne perputhje me Paragrafin 11 te Aneksit 16;
Certifikata e Pranimit Perfundimtar	quhet nje certifikate kryesisht ne formen e Shtojces 3 te Aneksit 6;
Pullat fiskale	quhet pulla e qeverise Shqiptare qe do ti vendoset Produkteve dhe, ne perputhje me

	Nenin 3.6 te kesaj Marreveshje, produkteve shtese qe Autoriteti mund te kerkoste dhe per te cilat Koncesioneri ka rene dakort;
Qendra e Shperndarjes se Pullave Fiskale	quhet ambienti i Autoritetit ne Tirane ku Koncesioneri shperndan Pullat Fiskale dhe tek i cili Autoriteti shperndan Pullat Fiskale per Prodhuosit;
Ngjarje Force Madhore	quhet cdo ngjarje qe ndikon ne permbushjen e detyrimeve nga nje Pale qe vjen nga veprime, ngjarjet, mosveprime pertej kontrollit te saj te arsyeshem,, duke perfshire aktet e Zotit, kryengritjet, lufrat ose konfliktet e armatosura, aktet e terrorizmit, aktet e qeverise, qeverise lokale ose Enteve Shteterore, zjarrin, permbytjen, stuhine, ose termetin, ose fatkeqesite por duke perjashtuar ndonje mosmarreveshje industriale ne lidhje me Koncesionerin, Personelin e Koncesionerit ose ndonje personel tjeter ne zinxhirin furnizues te Koncesionerit ose Nenkontraktuesit;
Raporti Kriminalistik	ka kuptimin qe i eshte caktuar ne Nenin 17.9;
Linje Mbushje Totalisht Automatike	quhet nje linje prodhimi Produkti per te cilin procesi i plote nga mbushja deri tek paketimi eshte e automatizuar dhe qe prodhon 4,000 ose me shume njesi te Produktit per ore;
Data e Pare	quhet data e pare ne te cilien Sherbimet Operacionale jane siguruar ne lidhje me Produktet (duke perfshire Produktet Farmaceutike);
Praktika te Mira te Industrise	quhet ushtrimi ne ate shkalle aftesie, kujdesi, maturie, eficence, parashikimi dhe afati sikunder do te pritej nga nje kompani lider ne nje industri perkatese apo sektor te biznesit;
Hardware	quhet sistemi qendor i kompjuterave, makineria, paisjet e printimit, aksesoret e

	kompjuterit, komponentet hardware te rrjetit dhe lidhjet e komunikimit te blere nga Koncesioneri per perdonim te dedikuuar ne sigurimin e Sherbimeve ;
HoldCo	quhet SICPA HOLDING SA , nje shoqeri anonyme e organizuar sipas ligjeve te Zvicres;
Vleresimi i Impaktit	quhet nje vleresim i nje Kerkese per Ndryshim kryesish ne formen e Shtojces 2 te Aneksit 16;
Periudha e Zbatimit	quhet faza gjate se ciles Koncesioneri do te kryeje Sherbimet e Zbatimit, qe eshte periudha nga Data e Hyrjes ne Fuqi deri ne Daten e Pare;
Plani i Zbatimit	quhet plani per te cilin eshte rene dakort midis Paleve per kryejen e Sherbimeve dhe Sistemin e parashikuar nga kjo Marreveshje sic eshte percaktuar ne Aneksin 10;
Sherbimet e Zbatimit	quhen sherbimet e siguruara nga Koncesioneri per hartimin, nderitmin, testimon, zbatimin dhe hapjen e Sistemit, Sistemit Qendror te Monitorimit te Gjurmave dhe Shenjave dhe Njesive Kompjuterike sic pershkruhen ne Aneksin 2;
Importuesi	quhet cdo person ose ent qe importon Produkte ne Shqiperi mbi baza tregtare;
Incident/e	quhet cdo ngjarje e cila nuk eshte pjesa e operacionit standart te Sherbimeve dhe qe shkakton, ose mund te shkaktoje, nje nderprerje te, ose nje reduktim ne, cilesine e atyre Sherbimeve;
Linja Fillestare e Prodhimit	ka kuptimin qe i eshte caktuar ne Aneksin 6;
Ngjarje e Paaftesise Paguese	quhet ngjarja e ndonje prej ngjarjeve te meposhtme ne lidhje me entitetin perkates :

	<p>(a) entiteti qe miraton nje rezolute per likujdimin ose nje urdher i nje gjykate kompetente per likujdimin ose mbylljen ose prishjen ne ndonje menyre tjeter te entitetit</p> <p>b) emerimi i nje adminstratori ose, marrja e nje urdhri adminstrimi ne lidhje me entitetin ose emerimi i nje marresi ose i nje marresi administrativ, ose i nje barre mbajtesi qe merr ne zoterim ose shet, nje pjese ose te gjitha zoterimet e entitetit, asetet, te drejtat ose te ardhurat;</p> <p>(c) entiteti qe ben nje marreveshje, kompromis ose ujdi per shlyerjen e borxheve te tij ndaj kreditoreve os e ndonje klase te tyre ose ndermerr hapa per te marre nje moratorium ose ben nje aplikim prane nje gjykate kompetente per mbrojtje nga kreditoret e tij;</p> <p>(d) entiteti nuk eshte ne gjendje te paguaje borxhet ose te jete i afte te konsiderohet i paafte te paguaje borxhet; ose</p> <p>(e) entiteti qe ben nje marreveshje, kompromis ose ujdi per shlyerjen e borxheve me kreditoret e tij ;</p> <p>ose cdogje ekuivalente ose analoge me sa me siper sipas ligjit Shqiptar;</p>
E Drejta e Pronesise Intelektuale ose DPI	<p>quhet:</p> <p>(a) e drejta e autorit, te drejtat ne lidhje me ose qe sigurojne mbrojtje te ngashme me te drejten e autorit, te drejtat ne baza te dhenash, patenta,</p>

	<p>dhe te drejtat ne shpikje, te drejtat gjysme percuese te topografise, markat , te drejtat ne emrat e domain ne Internet dhe adresat e websiteve dhe adresa te tjera ne emrat tregtar, dizenjo, Know-How, sektrete tregtare dhe te drejta te tjera per Informacionin Konfidential;</p> <p>(b) aplikime per regjistrime, dhe e drejta per te aplikuar per regjistrim, per cdo te drejte te listuar tek (a) qe jane te afte te registrohen ne cdo vend ose juridikcion; dhe</p> <p>(c) te gjitha te drejtat e tjera qe kane efekt ekuivalent ose te ngjashem ne cdo vend ose juridikcion ;</p>
Ankesa DPI	cdo ankesa per shkelje (duke perfshire mbrojtjen e kesaj shkelje) te cdo DPI te perdorur per te siguruar Sherbimet ose sic eshte parashikuuar ndryshe nga Koncesioneri (ose te cilit Koncesioneri i ka siguruar akses tek Autoriteti ne permbushjen e detyrimeve te tij).
Stafi Kyc	quhet cdo individ i listuar ne Aneksin 13, dhe ato individet shtese te cilet mund te emerohen si Staf Kyc kohe pas kohe ne perputhje me klauzolat e Aneksit 13 dhe Nenit 26 te kesaj Marreveshje;
Know-How	quhen te gjitha idete, konceptet, skemat, informacioni, njojurite, teknikat, metodologjia, dhe cdo gje tjeter e natyres se know-how qe lidhet me Sherbimet por duke perjashtuar know how qe kane qene ne zoterim te Koncesionerit ose Autoritetit perpara lidhjes se kesaj Marreveshje;
Prodhuesi i Shkalles se Gjere	quhet cdo prodhues i Produkteve (me perjashtim te produkteve farmaceutike) qe

	prodhon 500,000 ose me shume njesi te Produktit ne vit duke perdonur Linjat Plotesisht Automatike te Mbushjes se Automatizuar ;
Ligji	quhet cdo ligj, statut, akt nenligjor, dekret, rregullore, urdher, politike rregulluese, vendim gjykate ose direktive ose kerkese e cdo Entiteti Shteteror, legjislacion i deleguar ose i nenvaruar ose njoftim i cdo Entitet Shteteror , ne cdo rast sic eshte e zbatueshme kohe pas kohe ;
Certifikate e Arritjes se Instalimit te Linjes	quhet nje certifikate kryesisht ne formen e Shtojces1 e Aneksit 6;
Demtues I Software	quhet cdo program sofware ose kod I programuar per te shkaterruar, nderhyre, korruptuar, ose shkaktuar efekte te padeshirueshme tek dosjet e programit, te dhena ose informacion tjeter, kod i ekzekutueshem ose makro software i aplikueshem, pavaresisht nese ka ose jo veprim te menjehershem ose te vonuar, ose nese software eshte prezantuar me vullnet te plete, ose pa dijeni te ekzistences se tij ;
Prodhues	quhet cdo Prodhues i Shkalles se Gjere dhe cdo Prodhues i Shkalles se Ulet
Ceshtje Testi Material	quhet nje Ceshtje Testi e Niveleve te Rendesise1, 2, ose 3 ose nje kombimin i pese (5) ceshtjeve te testeve te Nivelit te Rendesise 4;
Milestone(Objektiv I Shenjestruar)	quhet nje ngjarje nje detyre e pershkruar ne Planin e Zbatimit i cili, nese eshte i aplikueshem, duhet te perfundohet ne Daten perkatese te Milestone; duke perfshire cdo Milestone ne lidhje me Autoritetin per te Proceduar;
Certifikate e Arritjes se Objektivit te	quhet nej certificate kryesisht ne formen e

Shenjestruar(Milestone)	Shtojces 2 te Aneksit 6;
Data e Shenjestruar	quhet data e vendosur kunder Milestone perkates ne Planin e Zbatimit;
Muaj	quhet nej muaj kalendarik dhe “ Mujor ” do te interpretohet respektivisht;
Te ardhura neto	quhen te gjitha te ardhurat qe Koncesioneri merr aktualisht si rezultat i kesaj Marreveshje per shitjet e Pullave Fiskale dhe cdo njesi tjeter te lidhur me te;
Raport i Mos-permbushjes	quhet nje raport qe perfshin detaje te arsyeve pse nje Test ka deshtuar ose te cdo jo-konfermiteti ne lidhje me cdo date te shenjestruar;
Periudha Operacionale	quhet periudha ne te cilen Koncesioneri do te shperndaje Sherbimet Operacionale, te identifikuara si te tilla ne Sherbimet Operacionale, te identifikuara si te tilla ne Planin e Zbatimit qe fillojne nga Data e Pare ;
Sherbimet Operacionale	quhet prodhimi, shperndarja ddhe monitorimi i Pullave Fiskale, si dhe sigurimi dhe mirembajtja e Sistemit te Monitorimit te Gjurmave dhe Shenjave dhe Njesive Kompjuterike;
Pale	quhet nje Pale e kesaj Marreveshje (dhe “ Palet ” do te nenkuptoje kete);
Patentat	quhen patentat e perdonura nga Koncesioneri per krijimin e Pullave Fiskale;
PCC	quhen ambientet ne Tirane ku do behet prodhimi sic percaktohet ne Aneksin 24;
Garancia e Kontrates	quhet garancia qe do te sigurohet nga Koncesioneri ne perputhje me Nenin 53 dhe Aneksin 12;

Te Dhena Personale	quhen te dhenat qe identifikojne nje person te gjalle;
Produkte Farmaceutike	Quhen te gjitha llojet e ilaceve dhe barnave te destinuara per perdonim ne diagnozat mjekesore, kurimin, trajtimin ose parandalimin e semundjeve, pervec ndonje ilaci ose medikamentesh per kafshet
Anetar i BMP	quhet cdo person i emeruar nga Autoriteti ose Koncesioneri ne Bordin e Menaxhimit te Projektit ne baze te Anekosit 19;
Pala Kryesore	quhet Autoriteti ose Koncesioneri;
Evidence Printimi	ka kuptimin e caktuar ne Aneksin 4;
Prodhues	quhet nje Prodhues ose Importues;
Produkte(t)	quhen produktet e duhanit, produktet e distiluara dhe te fermentuara te alkolit duke perfshire birren, Produktet Farmaceutike dhe produkte te tjera qe i shtohen qellimit te Sherbimeve kohe pas kohe ne perputhje me Nenin 3.6 te kesaj Marreveshje;
Prodhim	quhet kodimi dhe personalizimi i Pullave Fiskale;
Bordi i Menaxhimit te Projektit	quhet menaxhimi i bordit te themeluar ne baze te Anekosit 19 ;
Menaxheri i Projektit	quhet cdo person i emeruar i tille nga Autoriteti dhe Kocesioneri ne perputhje me Aneksin 19;
Komiteti Operacional i Projektit	quhet menaxhimi dite-pas-dite i projektit qe konsiston nga Menaxheret e Projektit ne baze te Anekosit 19;
Planet e Cilesise	quhet plani i Koncesionerit qe reflekton cilesine e sistemit te menaxhimit sic eshte

	pershkruar me tej ne Nenin 14 ;
3-mujor	quhet nje periudhe tre (3) mujore kalendarike qe fillon me 1 Janar, 1 Prill, 1 Korrik ose 1 Tetor perkatesisht;
Koncesioneri Zevendesues	quhet cdo pale e trete siguruese e Sherbimeve Zevendesuese e emeruar nga Autoriteti kohe pas kohe ;
Sherbimet Zevendesuese	quhen sherbimet te cilat jane kryesisht te ngjashme me cdonje prej sherbimeve dhe ato te cilat Autoriteti merr per te zevendesar cdonje prej sherbimeve qe ndjekin zgjidhjen e kesaj marrreveshje, pavaresisht nese keto sherbime jane siguruar nga vete Autoriteti ose nje pale e trete;
Perfaqesuesit	quhet Autoriteti ose Perfaqesuesi se bashku ose vec e vec dhe Perfaqesuesi i Koncesionerit;
Kerkesat	quhen kerkesat e Autoritetit ne lidhje me Koncesionin dhe Sistemin e percaktuar ne Aneksin 2 te kesaj Marreveshje;
Kodi i siguruar	quhet nje Pulle Fiskale qe konsiston ne nje kod sigurie te aplikuar direkt ne paketimin e Produktit dhe nuk I eshte aplikuar fillimisht nje banderole;
SAS	quhet sistemi i aktivizimit te sigurte sic eshte percaktuar ne Paragrafin 7.2 te Aneksit 3;
LKS	quhet linja e kodit te sigurte sic percaktohet ne Paragrafin 7.6 te Aneksit 3;
Politika e Sigurise	quhet politika e sigurise se Autoritetit qe i sigurohet Koncesionerit kohe pas kohe duke perfshire politiken e publikuar te Autoritetit per menaxhimin e sigurise se informacionit ;

Kreditet e Sherbimit	quhet shuma qe duhet paguar ne rast se Koncesioneri nuk arrin te permbushe nje ose me shume Nivele Sherbimesh sic specifikohet ne Aneksin 5;
Deshtimi i Sherbimit	quhet nje deshtim per te dhene ndonje pjese te Sherbimeve ne perputhje me Nivelet e Sherbimit ;
Nivelet e Sherbimit	quhen nivelet e sherbimit qe kerkohen te jepen, sic parashikohet ne Aneksin 5;
Pikat e Sherbimit	ka kuptimin qe i eshte caktuar ketij termi ne Aneksin 11;
Sherbimet	quhen Sherbimet e Zbatimit dhe Sherbimet Operacionale;
Transferimi i Sherbimeve	quhet cdo transferim i Sherbimeve (ose cdo pjese e Sherbimeve), per cfaredolloj arsyje, nga Koncesioneri ose nje Nenkontraktues tek Autoriteti ose Koncesioneri Zevendesues;
Data e Transferimit te Sherbimeve	quhet data qe te gjitha Sherbimet jane transferuar nga Koncesioneri ose tek Autoriteti ose tek Koncesioneri Zevendesues ;
Niveli i Sigurise	quhet niveli i rendesise sic percaktohet ne Seksionin 4 te Aneksit 5;
Prodhuesit e Shkalles se Ulet	quhet (i) cdo prodhues i Produkteve (me perjashtim te Produkteve Farmaceutike) qe prodhon 500,000 ose me pak Produkte ne vit ose qe nuk perdor Linjat e Mbushjes Plotesisht te Automatizuara dhe (ii) cdo prodhues i Produkteve Farmaceutike pavaresisht numrit te Produkteve te prodhua;
Zgjidhja	quhet zgjidhja e propozuar e Koncesionerit e percaktuar ne Aneksin 3 se si ai do te siguroje Sistemin, Njesite Kompjuterike, Sistemin e Monitorimit te Gjurmeve dhe Shenjave ne

	perputhje me Kerkesat;
Software i Shkruar Specifikisht	quhet cdo software i krijuar nga Koncessioneri (ose nga nje pale e trete ne emer te Koncesionerit) specifikisht per qellimet e kesaj Marreveshje ;
Procedurat e Mbikeqyrjes se Stafit	quhen procedurat e Autoritetit per mbikeqyrjen e personelit, roli i te cileve do te perfshije trajtimin e informacionit te nje natyre sensitive ose konfidenciale ose trajtimi i te cilit i nenshtrohet cdo mase sigurie perkatese;
Standartet	quhen politikat e brendshme te Autoritetit dhe procedurat dhe kodet e qeverise per praktiken dhe udhezimin e referuar ne Aneksin 20 se bashku me cdo politike tjeter te specifikuar ose procedurat e identifikuara ne Aneksin 20 ;
Entet Qeveritare	quhen ato departamente qeveritare Shqiptare dhe ente te tjera rregullatore dhe statutore, komitete dhe organe te cilat, qe ose sipas stautit, rregullave, rregulloreve, kodeve te praktikes ose e kunderta, jane te autorizuara te rregullojne, investigojne, ose influencoje ceshtjet te lidhura me kete Marreveshje ose cdo ceshtje tjeter te Autoritetit dhe “Entitet Shteteror” do te kene kete kuptim;
NenMarreveshje	quhet cdo Marreveshje ose marreveshje ose Marreveshje e propozuar ose marrevshje midis Koncessionerit dhe cdo pale te trete ku pala e trete bie dakort ti siguroje Koncessionerit Sherbimet ose cdo pjese te saj ose ambientet ose sherbimet ose cdo pjese te saj ose te nevojshme per menaxhimin, drejtimin ose kontrollin e Sherbimeve te cdo pjese te saj ;

Nenkontraktues	quhet cdo pale e trete me te cilen Koncesioneri lidh nje NenMarreveshje ose me sherbyesit ose agjentet dhe cdo pale te trete me te cilen ajo pale e trete lidh nje nenkontrake ose sherbyesit ose agjentet e saj ;
Sisitemi i Supotit te Mjeteve	quhet nje sistem qe perdoret per te monitoruar ngjarjen e nje Deshtimi Sherbimi dhe per te identifikuar mirembajtjen korrektive qe kerkohet per te korriguar Deshtimet e Sherbimit;
Sistem	quhen te gjitha Software-t, Hardware-t dhe materialet e tjera te perdoruara nga Koncesioneri duke perfshire Njesite Kompjuterike dhe Sistemin e Monitorimit te Gjurmave dhe Shenjave per te ndihmuar ne sigurimin e Sherbimeve ;
Taksat	quhen te gjitha format e taksimit aktual dhe te ardhshem , taksat, tatimet, tarifat, normat, zbritjet, detyrimet, kredite e detyrueshme dhe ndalesat e cdo lloji (me cfareolloj emir te quhen) te vena, te vleresuara ose te ngarkuara nga cdo Ent Shteteror duke perfshire cdo gjobe dhe interes ne lidhje me to;
Afati	quhet periudha e percaktuar ne Nenin 3.2;
Asistenca e Zgjidhjes	quhet asistenca qe do te sigurohet nga Koncesioneri per Autoritetin ne menyre qe te kryeje dorezimin te nje pjese ose te gjithe Sherbimeve nga Koncesioneri tek Autoriteti ose tek nje Koncessioner Zevendesues ne perputhej me klauzolat e Aneksit 22 ;
Njoftimi i Zgjidhjes	quhet nje njoftim per te zgjidhur kete Marrevshje ose pjese te Sherbimeve menjehere ose ne daten e specifikuar ne njoftim;
Leshimi i Testit	quhet cdo gabim, problem ose e mete ne

	perputhje ose jo me ndonje nga Mallrat me specifikimet e tyre perkatese duke perfshire cdo mosperputhje me ndonje prej kerkesave te percaktuara tek Kerkesat, Politika e Sigurise dhe kudo tjeter ne kete Marreveshje ose cdo Aneks sic mund te jete e aplikueshme te atyre Mallrave sipas Niveleve te Sigurise;
Kriteri i Suksesit te Testit	quhet kriteri i vendosur ne Aneksin 6 ne lidhje me Testet;
Plani i Testimit	quhet se plani per kryerjen e Procedures se Testimit te Mallrave sic eshte pershkruar ne Aneksin 6 ;
Procedurat e Testimit	quhen procedurat e aplikueshme te testimit dhe Kriteri i Suksesit te Testit sic eshte percaktuar ne Shtojcen 1 te Aneksit 6;
Testet	quhen testet e kerkuara ne perputhje me Nenin 6, dhe " Testimi " do te nekuptoje kete;
Software i Pales se Trete	quhet software i cili eshte ne pronesi te cdo pale te trete pervecse nje Filiali te Koncesionerit;
Njesi	quhet cdo Pulle Fiskale individuale e prodhuar dhe e shperndare nga Koncesioneri ne perputhje me kete Marreveshje;
TVSH	quhet taksa e vleres se shtuar ose taksa e shitjes sic parashikon Ligji Shqiptar;
Dite Pune	quhet nje dite ne te cilen kryhet biznes ne Republiken e Shqiperise, me perjashtim te festive zyrtare dhe te shtunave dhe te dielave.

Aneksi 2 – Kerkesat e Autoritetit

Pjesa A – Kerkesat ne lidhje me Pullat Fiskale

1. Autentifikimi i nivelit te pare: Tipari i sigurise se dukshme

- 1.1 Pullat Fiskale duhet te permbajne te pakten nje (1) tipar sigurie te dukshem qe ndihmon ne autentifikimin vizual te pambikeqyrur te Pullave Fiskale. Ky tipar duhet te jete sa me i pafallsifikueshem qe eshte e mundur, keshtu qe tipari i sigurise se dukshme duhet te permbushe te pakten me kerkesat e meposhtme:
 - 1.1.1 Te sigurohet nje pershkrim te detauar ne lidhje me zinxhirin furnizues te plete dhe te sigurte ne prodhimin e tiparit te dukshem bazuar ne burimet e kontrolluara te perberesve;
 - 1.1.2 Koncesioneri duhet te jete prodhues i elementeve te sigurise dhe net e njejten kohe te propozoje tipare te sigurise te dukshme.
 - 1.1.3 Koncesioneri do te propozoje nje dizenjo te Pulles Fiskale per klasifikimin e takses, duke perfshire kete tipar te dukshem.
 - 1.1.4 Koncesioneri do te propozoje nje Dizenjo te Pulles Fiskale ku do te peerdoret nje boje speciale shumengjyreshe (me ngjyre qe ndryshon ne varesi te kendit te drites). Dizenjo e Pulles fiskale duhet te permbaje te pakten keto tipare te dukshme:
 - (a) emblemen e Autoritetit (Republika e Shqiperise, Minsitria e Financave emblemen me shqiponje);
 - (b) nje numer serial (te padukshem);
 - (c) klasin e produktit;
 - (d) nje vlere akcize qe i korrespondon produktit;

2. Autentifikimi i nivelit te 2-te: tipari gjysem i dukshem i sigurise

- 2.1.1 Per te lejuar autentifikimin e Pulles Fiskale, dhe produktin tek i cili vendoset nga prodhuesit, importuesit, eksportuesit dhe distributoret, Koncesioneri do te propozoje te pakten nje tipar sigurie gjysem te dukshem. Ky autentifikim gjysem i fshehte nuk duhet te jete i dukshem me sy te lire .

2.1.2 Koncesioneri do te propozoje nje mjet specifik te brendshem te dizenjuar dhe hartuar nga brenda ne menyre qe te lejoje autentikim te lehte te ketij tipari sigurie gjysem te fshehte. Ky mjet specifik do te jete kompakt, te mbahet ne dore dhe te kete peshe te lehte, te mos kerkoje trajnim dhe te jete i lehte per tu perdorur.

3. autentifikimi i nivelit te 3-te: tipari i fshehte i sigurise

3.1 Koncesioneri do te propozoje te pakten dy (2) tipare sigurie te fshehta ne cdo Pulle Fiskale .

3.1.1 Tipari i pare i sigurise se fshehte do te jete perdorimi specifik i bojes se sigurise (siguri e bazuar nematerialet) dhe tipari i dyte i sigurise se fshehte do te jete perdorimi i nje kodi unik shume te sigurte te enkriptuar ne cdo Pulle Fiskale (siguri e bazar ne informacion).

3.1.2 Pervec tiparit te fshehtesise se permendur me lart, Pullat Fiskale do te jene te dizenjuara ne are menyre qe ne qofte se Pulla Fiskale ndryshohet ose riprodhohet me anen e fotokopjimit, riprodhimit dixhital ose mjeteve te tjera, d.m.th fallsifikohet, kopja rezultuese nuk do te mund te identifikohet si Pulle Fiskale e vlefshme. Dy nivelet e siperpermendura te autentifikimit duhet te demonstrohet lethesisht nga Koncesioneri .

4. Autentifikimi i nivelit te 4-rt: tipari i sigurise ligjore

Per te riforcuar sigurine e Pulles Fiskale , teknologja e pigmentimin special do te perdoret per sigruar nje shenues kriminalogjik. Ky tipar sigurie duhet te jete shume rezistent ndaj sulmeve kimike dhe fizike dhe shume i veshtire per tu zbuluar si teknologji.

Pjesa B – Kerkesat ne lidhje me Sherbimet e Zbatimit dhe Sherbimet Operacionale

5. Kerkesat e Zbatimit

- 5.1 Koncesioneri do te percaktoje Vendndodhjen Qendrore te Prodhimit ne Shqiperi ne ambientet e percaktuara ne Aneksin 24 ku do te ngreje Sistemin (me perjashtim te procesit konveisional te printimit dhe te Sistemit te Monitorimit te Gjurmave dhe Shenjave) dhe do te siguroje Sherbimet.
- 5.2 Koncesioneri do te dizenjoje, zhvilloje, operoje dhe mirembaje Sistemin per te lejuar Prodhimin e Pullave Fiskale, shperndarjen, monitorimin dhe procesin e kontrollit qe perdon Patentat dhe licencat e percaktuara ne kete Marreveshje dhe te mundesojne identifikimin e Pullave Fiskale te sigurta te produara dhe te aplikuara tek:
 - 5.2.1 duhani dhe produktet e alkolit te fermentuara dhe te distiluara duke perfshire birren e prodhuar ne Linjen e Mbushjes Totalisht Automatike vendase ; dhe
 - 5.2.2 duhani dhe produktet e alkolit te fermentuara dhe te distiluara duke perfshire birren te cilat jane te importuara ose te produara ne prodhuesit e vegjel vendas; dhe
 - 5.2.3 Produktet Farmaceutike.
- 5.3 Koncesioneri do te propozuje zhvillimin, prodhimin dhe mirembajtjen e Njesive Kompjuterike per kontrollin ose autentifikimin e produkteve qe mbajne Pulla Fiskale.
- 5.4 Njesite e Kompjuterit do te:
 - 5.4.1 kene nje kohezgjatje baterie me te gjate se tete ore ne dite;
 - 5.4.2 kene memorje te mjaftueshme dixhitale per te ruajtur te gjithe informacionin qe mund te mblidhet nga Perdoruesi Fundor ose pjesetaret e stafit ne nje Dite Pune;
 - 5.4.3 jene te rezistueshem ndaj goditjeve te forta dhe kushteve standarte te punes dhe do te jene ne perputhje me standartin IP54 te Bashkimit European;
 - 5.4.4 nuk do te jene te disponueshem ne tregun e hapur;
 - 5.4.5 te jene dizenjuar vetem per perdonimin e percaktuar ne kete Marreveshje ne Shqiperi dhe nuk do te perdoren nga vende/shtete te tjera; dhe
 - 5.4.6 jene ne perputhje me standartet e aplikueshme te sigurise se punonjesve dhe duhet te bejne te mundur vizualizimin e informacionit te skanuar/kontrolluar se bashku

me verifikimin me anen e Sistemit te Monitorimit te Gjurmeve dhe Shenjave, te transportohen lethesisht dhe te mos kene nevoje per aksesore te tjere ne menyre qe te lexojne outputet.

- 5.5 Cdo Pulle Fiskale duhet te jete ne perputhje me kerkesat e identifikimit te sigurise se fshehte te percaktuara ne Pjesen A.
- 5.6 Koncesioneri do te krijoje Sistemin e Monitorimit te Gjurmeve dhe Shenjave per regjistrimin e te gjithe Pullave Fiskale , si dhe te proceseve te aksesit te drejtperdrejte (online) dhe jo te drejtperdrejte tek te dhenat mbi Pullat Fiskale, duke perfshire Pullat Fiskale te perdonura tek produktet e importuara dhe produktet vendase. Sistemi i Monitorimit te Gjurmeve dhe Shenjave duhet te vendozet brenda ambienteve te Ministrise se Financave dhe Sistemi do ta populloje ate me te dhena te targetuara per perdonimin e Autoritetit dhe ketyre te dhenave ne Pullat Fiskale sic kerkohet nga Autoriteti.
- 5.7 Per sa i perket prodhimit te produkteve te akcizes , Koncesioneri do te ofroje nje system kodi unik qe do te aktivizohet menjehere qe nga momenti i prodhimit, ne menyre qe ato te identifikohen pavaresisht vellimit te prodhimit.
- 5.8 Per sa i perket prodhimit te produkteve te akcizes , ku volumi i prodhimit ose kufizimet e infrastruktures se prodhuesve te tjere (p.sh. linjat e pa automatizuara) ose linjat e vendosura jasht Shqiperise nuk lejojne monitorimin e automatizimit te mesiperm , Koncesioneri do te ofroje nje system te tille unik kodesh i cili mund te aktivizohet me Sistemin e Monitorimit te Gjurmeve dhe Shenjave menjehere pas dorezimit te Pullave Fiskale, duke bere te mundur kontrollin e vlefshmerise dhe monitorimin e produkteve qe vulosen pas hedhjes ne tregun vendas.
- 5.9 Koncesioneri do te ofroje nje system te tille kodesh unike , te ngjashem me 5 me siper, te cilat mund te aktivizohen ne Sistemin e Monitorimit te Gjurmeve dhe Shenjave menjehere pas shperndarjes se Pullave Fiskale specifike, duke beret e mundur kontrollin dhe monitorimin e vlefshmerise se produktit te vulosur pas hedhjes ne tregun vendas.
- 5.10 Aplikimi i Pullave Fiskale ne Produktet e importuara eshte perjegjesi e importuesve perkates.
- 5.11 Koncesioneri do te garantoje qe stafi ose perdonuesit e fundit te pajisur me Njesi Kompjuterike do te jete ne gjendje te monitoroje dhe validitoje Pullat Fiskale bazuar ne verifikimin e kodeve te tyre dhe tiparave te bojes te regjistruar prane Sistemit te Monitorimit te Gjurmeve dhe Shenjave. Kjo do ti mundesoje atyre identifikimin ne 2 sekonda nese pulla eshte origjinale dhe nese ajo korrespondon me produktin ku eshte vendosur.

- 5.12 Kur perdoruesi i fundit ose stafi perdorin Njesite Kompjuterike per te verifikuar Pullat Fiskale te gjitha te dhenat qe lidhen me ate product do te jene ne dispozicion te perdoruesit te fundit ose anetareve te stafit me anen e njesise kompjuterike dhe ora dhe vendi i atij verifikimi do te regjistrohen ne Sistemin e Monitorimit te Gjurmave dhe Shenjave.
- 5.13 Nese Perdoruesi Fundor ose stafi perdor nje Njesi Kompjuterike per te bere te vlefshme nje Pulle Fiskale, Njesia Kompjuterike do te identifokoje per ate individ, minimalisht:
- 5.13.1 nese Pulla Fiskale eshte origjinale ose jo;
- 5.13.2 nese tarifa per Pullen Fiskale korrespondon me produktin ;
- 5.13.3 nese Pulla Fiskale eshte bere e vlefshme me pare ;
- 5.13.4 ne lidhje me produktet lokale:
- (a) daten dhe oren e prodhimit te produktit (ne rastin e Prodhuesve ne Shkalle te Gjere);
 - (b) vendi i prodhimit; dhe
 - (c) shoqeria prodhuese ,
- 5.13.5 ne lidhje me produktet e importit:
- (a) data dhe ora e porositjes se Pullave Fiskale ne Sistemin e Monitorimit te Gjurmave dhe Shenjave;
 - (b) daten dhe kohen e aktivizimit te Pullave Fiskale in Sistemin Qendor te Gjurmimit dhe Monitorimit te Gjurmave ;
 - (c) data e qarkullimit te Pullave Fiskale (d.m.th data e dergeses); dhe
 - (d) emri i prodhuesit.
- 5.14 Per Pullat Fiskale tek produktet farmaceutike validitimi i pulles nga perdoruesi i fundit ose stafi qe perdor nje Njesi Kompjuterike duhet te siguroje informacionin e meposhtem. Detajet duhet te behen te vlefshme ne nje faze te dyte :
- 5.14.1 emri i produktit;

5.14.2 forma- doza e produktit

5.14.3 Identifikuesi i Produktit

5.14.4 Emri I Prodhuesit;

5.14.5 Identifikuesi i produktit;

5.14.6 numri i lotit ose dergeses;

5.14.7 Sasia e prodhuar/importuar per kete numer te lotit ose dergese

5.14.8 Data e skadimit.

5.14.9 Data e Prodhimit

5.14.10 Cmimi i Prodhimit

5.14.11 Numri dhe data e certificates se regjistrimit

5.14.12 Numri dhe data e autorizimit tevecante te Ministrit

5.14.13 Data e autorizimit per shitje

5.14.14 Inspektori per gjegjes per auditimin

5.15 i gjithe telekomunikimi i perdorur nga Koncesioneri ne lidhje me Sherbimet do te enkriptohet dhe do te kete një lidhje te sigurte.

5.16 Koncesioneri duhet te propozoje një Sistem qe eshte shume mjaftueshmerisht fleksibel per tu adoptuar gjate Afatit per te qene ne perputhje me nevojat ne ndryshim te Autoritetit ne një menyre me koste efektive dhe te shpejte duke perfshire perdorimin e Pullave Fiskale tek produktet e paspecifikuara ende.

5.17 Sistemi i Monitorimit te Gjurmave dhe Shenjave duhet te jetë shume i sigurte, te jetë ne gjendje qe te parandaloje hyrjen e pautorizuar dhe te lejoje nivele te ndryshme te aksesit tek informacioni i bazuar ne perdorimin e nevojave te stafit dhe perdoruesve te fundit.

5.18 Sistemi i Monitorimit te Gjurmave dhe Shenjave duhet te jetë shume i besueshem nga ana operacionale dhe te perfshije plane te qarta dhe praktike per perballimin e aksidenteve dhe demeve.

- 5.19 Soistemi dhe Sistemi i Monitorimit te Gjurmave dhe Shenjave duhet te jete fleksibel qe te lejoje zbatimin e ndryshimeve te rena dakort ose perfshirjen e Produkteve shtese gjate Afatit dhe te lejoje Autoritetin te adaptohet me ndryshimet ne kete sektor dhe zhvillimet teknologjike .
- 5.20 Koncesioneri garanton ruajtjen pa deme te te gjithe suportit te te dhenave dhe suportit te te dhenave te Autoritetit. Koncesioneri duhet te monitoroje dhe identifikoje permiresimet potenciale ne lidhje me teknologjine e perdorur ne sistem.
- 5.21 Koncesioneri fitues, pas vendosjes se sistemit duhet te procedoje me certifikimin ne perputhje me standartet e pranuara nderkombetarisht nga autoritetet kompetente. Per sa i perket te gjitha certifikimeve, nje njoftim duhet te dergohet, paraprakisht dhe ne vazhdimesi, tek Autoriteti ne menyre qe te sigurohet perputhshmerine me standartet kombetare.
- 5.22 Dizenjimi funksional per Sistemin dhe Sistemin e Monitorimit te Gjurmave dhe Shenjave do te jete shume e larte dhe do te rakordohet e miratohet nga Palet.
- 5.23 Informacioni i ruajtur ne Sistem dhe ne Sistemin e Monitorimit te Gjurmave dhe Shenjave duhet te eksportohet ose transferohet lethesisht ne nje standart te rene dakord bashkarisht, ne nje format te hapur per tu perdorur nga sistemet e tjera pandonje perpunim te metejshem.
- 5.24 Aksesi tek funksionet e ndryshme te Sistemit dhe Sistemit te Monitorimit te Gjurmave dhe Shenjave do te jepet/refuzohet bazuar ne rolin e perdoruesit, identitetin dhe autenticitetin. Aksesi tek te dhenat e regjistruara brenda Sistemit dhe Sistemit te Monitorimit te Gjurmave dhe Shenjave do te jepet/refuzohet bazuar ne rolin e perdoruesit, identitetin dhe autenticitetin. Sistemi dhe Sistemi i Monitorimit te Gjurmave dhe Shenjave duhet te mundesoje ndarjen e funksioneve te stafit.
- 5.25 E gjithe puna e ndermanre per Sistemin e Monitorimit te Gjurmave dhe Shenjave ne lidhje me te dhenat duhet te jete e gjetshme nga ndonje individ dhe te jete e llogaritshme.
- 5.26 Sistemi do te jete ne gjendje te siguroje kontroll te plete te gjurmave.
- 5.27 Cdo transmetim i te dhenave midis Njesive Kompjuterike dhe Sistemit dhe Sistemit te Monitorimit te Gjurmave dhe Shenjave si dhe cdo akses tjeter nga Palet duhet te perdorin teknologji enkriptimi per te shmangur aksesin nga personat e paautorizuar gjate transferimit.
- 5.28 Transferimi i informacionit midis Njesive Kompjuterike dhe Sistemit dhe Sistemit te Monitorimit te Gjurmave dhe Shenjave duhet te realizohet afersisht ne kohe reale dhe

duhet te jete e mundur njezet e kater ore ne dite, shtate dite ne jave treqind e gjashtedhjete e pese dite ne vit on-line nepermjet lidhjes wireless kur eshte e mundur

- 5.29 Koncesioneri me kerkesen e Autoritetit do te krioje akses pa pagese per Entet Shteterore (DPT, DPD, QKKB, ose perdorues te tjere te autorizuar) ti mundesoje atyre akses tek Pullat Fiskale dhe tek te dhenat e tyre nga Sistemi i Monitorimit te Gjurmeve dhe Shenjave ne cdo kohe. Raportet e nevojshme per rolin e cdo perdoruesi do te percaktohen me fillimin e projektit se bashku me Autoritetin.
- 5.30 Kapacitet hardware dhe software te Sistemit dhe Sistemit te Monitorimit te Gjurmeve dhe Shenjave duhet te jene te pakten dy here me shume se prodhimi i sasise vjetore te kerkuar nga Autoriteti.
- 5.31 Koncesioneri do te jete perjegjes per mirembajtjen e Sistemit dhe Sistemit te Monitorimit te Gjurmeve dhe Shenjave duke perfshire sigurimin e Sistemit te Suportit te Mjeteve. Koncesioneri do te jete perjegjes per zevendesimin e cdo paisje te demtuar gjate Afatit me paisje me te njatat parametra, si dhe sigurime e komunikimit te drejtperdrejte midis te gjithe pikave te Sistemit, Sistemit te Monitorimit te Gjurmeve dhe Shenjave dhe Njesive Kompjuterike. Kosto aktuale per shkak te demit te shkaktuar nga prodhuesit tek cdo paisje ose mjet i sistemit do t'i ngarkohet prodhuesit.
- 5.32 Koncesioneri do te jete perjegjes per admisnistrimin dhe ruajtjen e te gjitha te dhenave te mbledhura ne lidhje me Pullat Fiskale ne Sistemin e Monitorimit te Gjurmeve dhe Shenjave gjate Afatit. Koncesioneri duhet te siguroje qe te gjitha te dhenat ne Sistemin e Monitorimit te Gjurmeve dhe Shenjave te jene te mbeshtetura tek nje baze e vecante te dhenash te Vazhdimesise se Biznesit e cila do te sinkronizohet cdo dite me Sistemin qendor te Informacionit ne nje vendndodhje te specifikuar nga Autoriteti ku mbeshtetjet ditore te bazes se te dhenave duhet te ruhen. Koncesioneri do te garantoje do te garantoje mirembajtjen e sigurte te mbeshtetjes se te dhenave ne Sistemin e Monitorimit te Gjurmeve dhe Shenjave .
- 5.33 Sistemi i Monitorimit te Gjurmeve dhe Shenjave i prodhuar nga Koncesioneri duhet te jete ne gjendje te gjeneroje informacion on-line per 3 (tre) vitet e fundit, dhe te jete ne gjendje te aksesojo informacion e arkivuar gjate 10 viteve te fundit.
- 5.34 Perpara Dates se Pare dhe fillimit te Sherbimeve Operacionale Koncesioneri do te siguroje dokumentet e meposhtem:
Lexuesi SICPAMOBILE® ka tipare sigurie te nivlet te larte si kpacitet per ruajtjen e informacionit te enkriptimit/dekriptimit, autentifikimin e perdoruesit, komunikimin e sigurte me Sistemin Qendor te Monitorimit te Gjurmave dhe Shenjave, enkriptimin e informacionit te ruajtur dhe logimi i aktiviteve. Mekanizmi i enkriptimit te sigurte eshte integruar ne komponentet e hardwarit te paisjes dhe eshte shume e sigurte ne rast nderhyrjeje.

Funksionaliteti

Funksionet e meposhtme jane te vlefshme per inspektoret e terrenit:

Opzioni Off-line (autentifikimi i kodit):

Opzioni Off-line eshte opzioni operacional kurdo qe paisja SICPAMOBILE® nuk eshte e lidhur me ndonje infrastrukturre komunikimi. Ne kete opzion, inspektoret e terrenit vizualizojne tiparin e fshehte te Pulles Fiskale ose produktit dhe autentikojne vlefshmerine e produktit. Ai verifikon tiparet e sigurise te bazuara ne material dhe ne informacion te kodit SICPADATA®. Per me teper, inspektoret e terrenit jane ne gjendje te identifikojnë tipin e pritshem te produktit (duhan, alkol, birre ose produkte farmaceutike) dhe te zbulojnë lehtesish mosperputhjet.

Per Blerten: Mungon figura 26 dhe pershkrimi



Figura 262627 : Foto e ekranit te formes online SICPAMOBILE®

Ne formen on-line, pas autentifikimit te sukseshem te kodit dhe paraqitjes se informacionit off-line te përshkruar me lart, inspektoret e terrenit mund te verifikojne (psh gjurmen) si me poshte:

- Lloji i produktit sic ai eshte regjistruar ne Sistemin Qendror te Monitorimit te Gjurmeve dhe Shenjave si dhe klasa e takses korresponduese dhe viti i prodhimit te Pulles Fiskale;
- Marka e produktit (me zgjedhje);
- Historia e auditeve te mëparshme te kryera me te njejten Pulle Fiskale;
- Per Produktet e Produhuara nga Prodhuesit ne Shkalle te Gjere: linja e prodhimit ne te cilin produkti eshte prodhuar, data dhe koha e prodhimit, emri i prodhuesit;
- Per Pullat Fiskale te para aktivizuara te shperndara tek prodhuesit e vegjel dhe importuesit: data e berjes se porosise dhe aktivizimi (shpërndarja tek importuesi) i Pulles Fiskale takse, emri i importuesit dhe prodhuesit qe kërkon Pullat Fiskale;
- Data e kodimit dhe aktivizimit te kodit SICPADATA®.

Per me teper, kur pajisja eshte online, i gjithe informacioni i auiditimit eshte si me poshte:

- Numri i kodeve te skanuara;

- Numri i skanimeve te pavlefshme te ndodhura;
- Identifikimi i paisjes;
- Informacioni mbi përdoruesin qe vepron me paisjen perkatese.

I gjithe informacioni i mesiperm shihet si një raport, nepermjet Sistemit Qendror te Monitorimit te Gjurmave dhe Shenjave dhe Aplikimit Web.

Te gjitha pjeset kritike te sistemeve hardware dhe software te dhena per Sistemin e Auditimit (SA) si dhe per te gjithe SICPATRACE® jane te mbrojtura ose nepemjet patentave ose politikes se sekreteve te tregtise.

Komunikimi me Sistemin Qendror te Monitorimit te Gjurmave dhe Shenjave

Lexuesi SICPAMOBILE® lidhet me Sistemin Qendror te Monitorimit te Gjurmave dhe Shenjave ose nepermjet komunikimit GSM/GPRS ose nepermjet një lidhje USB me ane te Kompjuterit te audituesit. Komunikimi midis Sistemit Qendror te Monitorimit te Gjurmave dhe Shenjave dhe sistemit te Auditimit eshte enkriptuar duke përdorur te pakten komunikimin standard 128 bit SSL ose mekanizmat e regjistruar te enkriptimit.




Figura 272728 : Arkitektura e rrjetit te Sistemit te Auditimit

Lexuesi SICPAMOBILE® lidhet me Sistemin Qendror te Monitorimit te Gjurmave dhe Shenjave nepermjet Serverit te Autorizuar SICPAMOBILE® duke siguruar një nivel te larte sigurie. Serveri i autorizuar SICPAMOBILE® identifikon dhe autentifikon cdo kerkese te ardhur dhe me pas e dergon ate tek Sistemi Qendror i Monitorimit te Gjurmave dhe Shenjave, i cili ndodhet brenda rrjetit te Ministrise Shqiptare te Financave.

Kjo arkitekture siguron një instalim ekstra te sigurise për teresine e informacionit në Sistemin Qendror të Nivelit të Monitorimit të Gjurmave dhe Shenjave

Kushte specifike

Vlefshmeria: Opto-Elektronike

<1sec per skanim

Permaza: 268x80x79mm

Pesha: 450g

Baterite: Li-Ion

Autonomia: 4 ore vazhdim skanimi

2 ore vazhdim GSM

(Kryesisht mbulon nevojat për një dite pune te audituesit)

20 ore makineri që nuk punon

Kalibrimi: Siguruar nga SICPA

Lexuesit SICPATRACE® mund te mbajne me shume se 1.8GB te te dhenave te cilat jane te barabarta me shume se 100,000 skanime, shumëfishime me shume se një dite tipike pune për një auditues.

Standartet dhe certifikimet e lexuesit SICPAMOBILE®:

Siguria:

CE ne përputhje me IEC60825-1

Shkalla e mbrojtjes:

IP54 ne përputhje me IEC 60529

Emetimet:

Testet e emetimit dhe imunitetit ne përputhje me

EN 55022A1/A2 Ed 98/00/03 dhe EN 301 489-7 V1.3.1

EN 61000-6-2 Ed 01, EN 301 489-7 V1.3.1 dhe

EN 301 489-17 V1.2.1

Kerkesat plotësuese:

Emetimi i paligjshem ne vazhdim EN 301 511 V9.0.2

Emetimi i paligjshem ne vazhdim EN 300328 V1.6.1




Figura 282829 : Dimensionet SICPAMOBILE®

Mjetet dhe pajisjet te planifikuara per tu përdorur per Sistemin e Pulles Fiskale Shqiptare jane përcaktuar dhe jane dhene ekskluzivisht per programet qeveritare kunder fallsifikimeve. Karakteristikat e pajisjeve, aplikimet e futura, siguria e përdoruesit si dhe kodimi dhe nënshkrimi i te dhenave do te përcaktohet dhe pershtatet ne menyre unike per programin Shqiptar te Pullave Fiskale.

7.8 Zbatimi SICPATRACE® per produktet farmaceutike ne Shqiperi

SICPA do te prodroje nje Pulle Fiskale te permiresuar per Produktet Farmaceutike dhe t'u siguroje audituesve te Qendres Kombetare te Kontrollit te Barnave ("QKKB"), Lexuesit Sipamobile per detyrat e tyre te auditimit.




Figura 292930 : Principi i Pergjithshem per (ilustrimin) Farmaceutik

1. Pullat Fiskale per produktet farmaceutike jane printuar nga një printer i sigurte i përzgjedhur nga SICPA duke ndjekur kërkesat e dhena nga SICPA dhe te shpërndara tek Qendra e Kodimit e ndoshur ne Tirane. Pullat e stampuara Jane prodhuar ne rrota prej pullash me vete ngjitur.
2. Kodet e padukshme SICPADATA® Jane aplikuar ne pullat e printuara tek Qendra e Individualizimit dhe Kodimit te SICPA e ndodhur ne Shqiperi. Rezultatet i këtij procesi Jane koduar ne menyre te sigurte por akoma nuk Jane individualizuar ne rrota te Pullave Fiskale me vete ngjitur. Rrotat e Pullave Fiskale te Koduara por jo te individualizuara mbahen ne magazine tek PCC ne Tirane per individualizimin e kërkuar me vone.
3. Pullat e koduara por jo te individualizuar, individualizohen duke përdorur makinën individualizuese SICPA per cdo porosi. Kodi i padukshem do te shoqerohet me te dhenat persa i perkite produktit ne kete faze.
4. Pullat fiskale me pas merren nga prodhuesit vendor ose i jepen një agjencie transporti ne rastin e mallrave te importuara per aplikimin e tyre manual ose te automatizuar tek produktet. Pullat Fiskale aplikohen duke ndjekur procesin aktual nga prodhuesit vendor (nen mbikëqyrjen e inspektoreve duke ndjekur proceset e QKKB) dhe do te transportohen

jashte nga PCC per Produktet Farmaceutike te importuara. Keshilli i Ministrave nese kërkohet do te leshoje një liste te Produkteve Farmaceutike per te cilat aplikimi i Pulles Fiskale mund te behet nga importuesi ne Shqiperi nen mbikëqyrjen e inspektoreve te QKKB. Ne kete rast te fundit Pullat Fiskale per keto produkte specifike do ti jepen importuesit ne PCC.

5. Pullat me pas verifikohen ne kushtet e importuesit ose te prodhuesit lokal nga inspektoret per te bere te sigurte se te gjitha te dhenat e mbledhura ne DMS perputhen me vete produktin.
6. Perfundimisht Pullat Fiskale per produktet farmaceutike mund te verifikohen ne tregun e hapur dhe te mbyllur nga Inspektoret duke përdorur Skanerat Sicipamobile.

Pulla Fiskale per produktet Farmaceutike dhe te dhenat shoqeruese

Me qellim qe te siguroje monitorimin e prodhimit, importimin dhe shpërndarjen e produkteve farmaceutike ne Shqiperi SICPA propozon një Pulle Fiskale te re, unike te permiresuar per produktet Farmaceutike duke perfshire një kod SICPADATA® te padukshem.

Pulla Fiskale per produktet farmaceutike do te permbaje vecorite e mëposhtme:

1. Vecoria e sigurise se dukshme (siguruar nepermjet bojes SICPASTAR®)
2. Vecoria e Sigurise gjysmë e mbuluar (siguruar nepermjet bojes SICPA OASIS®)
3. Individualizimi i dukshem ne përputhje me kërkesat e Ministrit se Shendetit e cila do te permbaje:
 - a. Emrin e produktit duke perfshire dozen e treguesit
 - b. Çmimi i produktit ne LEK ose DONACION (donacion) ose SPITALOR (treguesi spitalor)
 - c. Emri i Importuesit/Prodhuesit ne formen e kodeve 2 shifrore
 - d. Kodin e dukshem te references.
4. Nje kod SICPADATA® te padukshem

Pervec këtij informacioni vijues do te ruhet ne Sistemin e Menaxhimit te te Dhenave dhe i gatshem per audituesin nepermjet lexuesit SICPAMOBILE® gjate auditimeve te fushes:

1. Emri i Produktit
2. Forma – Doza e produktit
3. Identifikuesi i Produktit
4. Emri i Prodhuesit
5. Identifikuesi i e Prodhuesit
6. Numri i pjeses ose ngarkeses
7. Sasne e prodhuar/importuar me kete numrte pjeses ose ngarkeses
8. Data e skadimit
9. Data e Prodhimit
10. Cmimi i produktit
11. Numri dhe data e certifikates se regjistrimit
12. Numri dhe data e autorzimit te vecante te Ministrit
13. Data e autorizimit per shitje
14. Inspektoret persegjegjes per auditimin

[Pas Dates se Pare Koncesioneri do te pergatise nje plan shperngulje te pulles e dyfishte per Produktet Farmaceutike te perbashketa me QKKB. Nje pulle e tille e dyfishte do te perbehet nga nje pulle baze e cila mbetet ne Produktin Farmaceutik dhe nje pulle qe shqitet e cila do te hiqet nga paketimi nga farmacisti dhe do te vendoset brenda recetes per te kontrolluar kompesimin nga sigurimi shendetor.]

Prodhimi i Pulles i kerkuar nga NCDC

Informacioni i lidhur me cdo Pulle Fiskale te prodhuar per Produktet Farmaceutike do te jepet per Koncesionerin nga stafi i NCDC si pjesa e kerkeses se prodhimit te pullave.

Kerkesa per prodhimin e Pullave do te jepet nga QKKB per Koncesionerin me mjetet e Sistemit te Monitorimit te Gjurmese Qendrore dhe Shenjave sa po kerkesa e prodhuesit te miratohet nga QKKB. Ne rastin e mallrave te importuara kerkesa e prodhimit te pulles jepet nga QKKB per Koncesionerin sa po i gjithe informacioni per importimin miratohet nga QKKB jepet autorizimi per lejen e nisjes se porosise.

Ne rastin e Pullave Fiskale per produktet Farmaceutike te cilat trasportohen jashtë QKKB vlereson adresen dhe detajet e kontaktit te dhena nga importuesi dhe i sigurojne adresen e vlefshme Koncesionerit me ane te mjeteve te Sistemit te Monitorimit te Gjurmese Qendrore dhe Shenjave se bashku me kerkesen e prodhimit te pulles.

Pas Dates se Pare Koncesioneri do te pergatise nje plan shperngulje ne nje marreveshje te perbashket me QKKB ndaj platformes web te berjes se porosise e cila do te vihet ne dispozicion te Importuesve dhe Prodhuvesve me qellim qe t'i lejoje at ate paraqesin te dhenat brenda kerkeses se tyre te autorizimit te importit ne rastin e produkteve Farmaceutike te importuara ose kerkeses se pulles ne rastin e Produkteve Farmaceutike te prodhua ne vend.

Procesi i Prodhimit te Pulles Fiskale per Produktet Farmaceutike

Pullat Fiskale te Sigura do te kodohen ne PCC. Rrotat e para-koduara por jo te individualizuara (individualizim i dukshem jo i printuar) rrotat me vetengjite vendosen ne magazine per individualizimin e kerkuar.

Sapo leshohet autorizimin per shperndarjen e pullave nga QKKB pullat individualizohen duke perdorur nje makine individualizuese SICPA. Makina individualizuese aplikon informacionin e dukshem lidhur me produktin dhe shoqeron kodin e padukshem unik te Pulles Fiskale per produktin ne bazen e te dhenave.

Shperndarja e Pulles Fiskale per produktet farmaceutike

Pullat Fiskale te Sigurta te perfunduara per Produktet Farmaceutike ose do te magazinohen ne PCC ose do te dergohen ne adresen e dhene nga importuesi duke marre nje miratim nga QKKB apo te sigurohet prova e pageses.

Aplikimi i Pullave Fiskale per produktet Farmaceutike

Pullat Fiskale per Produktet Farmaceutike aplikohen nga prodhuesit e vendit dhe te huaj, stampuesit ose importuesit ose duke perdorur aplikuesit automatike te etiketes ose manual nen kontrollin e inspektoreve te QKKB sic eshte bere sot.

Aktivizimi i Pulles Fiskale per Produktet Farmaceutike

Sapo pullat aplikohen ne produkt dhe produktet jane te pranishme ne vend inspektoret nga QKKB verifikojne saktesine e informacionit te printuar ne pulle dhe lidhur me pullen ne databazen nga linja kryesore e lexusit SICPAMOBILE® ne paraqitjen e prodhimit te vendit ose ne rastin e mallrave te importuara ne magazinen e importuesit.

Inspektor verteton se te gjitha te dhenat jane te sakta. Sapo kthehet ne zyre inspektori paraqet ndryshimet e mundshme ne Sistemin e Monitorimit te Gjurmës Qendrore dhe Shenjave dhe autorizon mallrat per shitje. Sapo Produktet Farmaceutike autorizohen per shitje Pullat Fiskale ne lidhje me to aktivizohen ne sistem.

Procesi rrjedh per shitjen e e Produkteve Farmaceutike me ane te mjeteve te Sistemit te Monitorimit te Gjurmës Qendrore dhe Shenjave dhe perqegjesit e ngarkuar per vleresimin e ketij autorizimi do te bien dakord midis QKKB dhe Koncesionerit.

Inspektimi i Pullave Fiskale per Produktet Farmaceutike

Te gjitha Pullat Fiskale per Produktet Farmaceutike mund te auditohen ose ne magazinat e importuesve ose ne tregjet e hapura dhe te mbyllura nga inspektoret duke perdorur Skanerat Sicpamobile. Skanerat Sicpamobile ne menyre online do te mbledhin te dhena nga data baza dhe do te garantojne informacionin e meposhtem audituesit per cdo produkt te skanuar:

1. Emri i produktit
2. Forma – doza e produktit
3. Identifikuesi i prodhimit
4. Emri I Prodhuesit
5. Identifikuesi i Prodhuesit
6. Numri i pjeses ose ngarkeses
7. Sasia e prodhuar/importuar per ate numr pjeze ose ngarkese
8. Data e skadimit
9. Data e prodhimit
10. Cmimi i Produktit
11. Numri dhe data e regjistrimit te certificates

12. Numri dhe data e autorizimit te vecante te Ministrit
13. Data e autorizimit per shitjen
14. Inspektori perqejjes per autorizimin

Pasi hyjme brenda nderfaqes se Skanerit Sicipamobile, inspektori do te jetë ne gjendje te hape nje sesion auditimi dhe te raportoje farmacie/importuesin/prodhuesin ose identifikuesin e spitalit perpara se te filloje skanimi i Produkteve te kontrolluara.



Figura 303034 : Skaneri Sicipamobile per inspektoret

Raportet per QKKB

QKKB do te jape raporte mbi kodimin e Pullave Fiskale, mallrat dhe individualizimin si dhe raportet e auditit sic paraqiten ne **Aneksin 21- Te dhenat**.

Zbatimi i Projektit dhe fazat

Koncesioneri do te zbatonte te gjitha funksionet e kerkuara per te lejuar kerkesen e prodhimit te Pullave dhe aktivizimin e pullave si dhe nje pulle te re te sigurt duke perjashtuar pullat e dyfishta brenda fazes se pare duke perfunduar ne daten e pare.

Pas dates se pare, aplikimi i Procesit aktual te Kontrollit te ilaceve do te shperngulet tek platforma SICPATRACE® dhe te gjitha ekranet dhe nderfaqet e ndryshme aktuale do te pershtaten ose riprodhohen dhe formularret e autorizimit do te nxirren direkt nga nderfaqja e web klientit te Gjurmes Qendrore dhe Sistemit monitorues te Gjurmes ne dispozicion te personelit te autorizuar te QKKB. Per me teper nje plan njohes per formatin e pullave te reja te dyfishta me siperfaqe qe

shqitet do te propozohet nga Koncesioneri. Pervec se nese bihet dakort ndryshe ndermjet Autoritetit dhe Koncesionair, pulla e dyfishte do te perfshije karakteristika sigurie dhe informacion te ngjashem psh te dhena te dukshme dhe te padukshem, si dhe per pullen e njefishte. Linja e kohes dhe detajet e kesaj faze te dyte do te miratohet midis QKKB dhe Koncesionerit ne kohen e duhur sapo te arrihet Data e Pare.

Fazat dhe linjat e kohes paraqiten ne **Aneksin 10 – Plani i zbatimit**.

7.9 Sistemi i Monitorimit te Gjurmës Qendrore dhe Shenjave – Sistemi i Monitorimit te Gjurmës Qendrore dhe Shenjave SICPATRACE®

7.9.1 Veshtrim i Pergjithshem i sistemit

Sistemi i Monitorimit te Gjurmës Qendrore dhe Shenjave SICPATRACE® (gjithashtu i referohet DMS) garanton sherbime (duke perfshire autorizimin per kodimin) dhe ruajtjen e te dhenave te centralizuara per te gjitha nensistemet (PCC, SAS, SCL, AS, DeS) te sistemit SICPATRACE®. Nje depo qendrore ruan te dhenat nga kodimi i produktit, aktivizimi dhe autenticiteti i fushes per sellime raportuese dhe analizuese.

Sistemi i Monitorimit te Gjurmës Qendrore dhe Shenjave do te ofroje nivele te larta te sigurise dhe performances me qellim qe te plotesoje nevojat e Ministrise se Financave dhe Drejtore se Pergjithshme te Taksave. Sistemi i Monitorimit te Gjurmës Qendrore dhe Shenjave do te pranohet pa kushte nga Drejtoria e Pergjithshme e taksave ne nje hapesire te dedikuar ose ne nje sall te pajisur me kompjutera.

7.9.2 Kerkesa funksionale

Sistemi i Monitorimit te Gjurmës Qendrore dhe Shenjave do te garantoje funksionet e meposhtme:

1. Menaxhimi i te dhenava te konfiguruara te nevojshme per funksionimin e te gjitha nensistemeve
 - a. Vendet e prodhimit, markat, çlesat e kriptografise etj
2. Marrja dhe mbledhja e te dhenave gjate ciklit jetesor te plete te produktit
 - a. Faza e kodimit me PCC
 - b. Faza e shperndarjes me DES
 - c. Faza e aplikimit dhe aktivizimit me SAS, SCL

d. Faza e auditit me AS

3. Menaxhimi i procesit te qarkullimit te Pulles Fiskale

- a. Porosia e Pulles Fiskale nga zyra rjonale GDT
- b. Autorizimi i Prodhimit te Pulles Fiskale nga Menaxhimi qendror GDT
- c. Statusi i ndjekjes se prodhimit dhe shperndarjes

4. Raportimi nepermjet aplikimit web ne Ministrine Shqiptare te Financave

- a. Raporte lidhur me Pullat Fiskale te audituara nga inspektoret e Fushes
- b. Raportet e ndjekjes (kodimi– shperndarja- aktivizimi)
- c. Raporte te printuara ose kontrollin, monitorimin dhe parashikimin
 - i. Prodhimi i Pullave Fiskale te Sigurta
 - ii. Aplikimi dhe aktivizimi i pullave te sigurta ose aktivizimi i koveve per produktet e birres (kodet e aktivizuara dhe numri i koveve te aktivizuara etj...)
 - iii. Humbja e Pullave fiskale te Sigurta (Pullat fiskale te cilat nuk jane aktivizuar brenda nje periudhe kohe te arsyeshme)
 - iv. Fallsifikimi i pullave fiskale (Pullat fiskale te sigurta te panjohura per Sistemin e Monitorimit te Gjurmës Qendrore dhe Shenjave)
 - v. Rezerva e Pullave Fiskale te Sigurta
 - vi. Pullat fiskale te vjedhura
 - vii. Pullat fiskale te demtuara

5. Raportet Diagnostikuse

Raporti i nxjerre nga Sistemi i Monitorimit te Gjurmës Qendrore dhe Shenjave do te jetë ne gjuhen shqipe dhe angleze.

7.9.3 Arkitektura e Sistemit te Monitorimit te Gjurmës dhe Shenjave

Sistemi i Monitorimit te Gjurmës Qendrore dhe Shenjave si dhe Qendra e Rregullimit te Demtimit te Sistemit te Monitorimit te Gjurmës (duke përshtire te gjithe hardware, software etj) do te integrohet brenda infrastrukturës fizike ekzistuese IT ne kushtet e Autoritetit ne vendet e miratuar; por do te mbetet plotesish e pavarur ne termat e sigurisë fizike dhe llogjike. SICPA do te jape rekomandim persa i perket infrastrukturës pritese, sigurise dhe standardeve te kontrollit te aksesit që do te ndiqen.

Strategjia e zbatimit te sistemit do te garantoje një platforme te sigurte per elementet software te Sistemi i Monitorimit te Gjurmës Qendrore dhe Shenjave.




Figura 313132 : Sistemi i Monitorimit te Gjurmës Qendrore dhe Shenjave Arkitektura e Vendit kryesor




Figura 323233 : Sistemi i Monitorimit te Gjurmës Qendrore dhe Shenjave Arkitektura e Vendit te rregullimit te demtimit

Elementet:

1. LAN: Elementet ne kete nen rrjet jane te aksesueshme vetem per stafin teknik te autorizuar te Autoritetit dhe nga makinat e autorizuara te perzgjedhura nga DMZ (zone e de- Militarizuar).
2. Serveri i te dhenave: Serveri i te dhenave drejton Softwerin e Te dhenave Standarte te ndermarrjes per te siguruar teresine te dhenave, performanceen dhe matjen per te gjitha te dhenat
3. RAID DAS: Zgjidhja e ruajtjes direkte te bashkengjitur garanton nje nivel te larte te teprices dhe gadishmerise permes disqeve me shpejtesi te larte per te siguruar mbrojtjen dhe disponueshmerine e te dhenave.
4. Biblioteka e regjistrimit : Biblioteka e regjistrimit garanton nje zgjidhje te automatizuar per mbrojtjen e te dhenave per aplikimin e te dhenave dhe dosjet e konfiguruara ne median e levizshme me performance te larte.
5. Zona e De – Militarizuar (DMZ): Elementet ne kete nen rrjet jane te aksesueshme nga Interneti ose drejtperdrejtje (nepermjet Serverit Web Cluster dhe Serverit SICPAMOBILE®) ose nepermjet Rrjetit Privat Virtual (Aplikimi & Serveri Web).

6. Aplikimi & Serveri Web: Aplikimi dhe serverat web garantojnë platformen per Aplikimin Web per Autoritetin dhe te gjithe elementet software per nensistemet PCC, SICPATRACE®.
7. Sherbimi i autorizuar SICPAMOBILE®: Sherbimi i autorizuar SICPAMOBILE® garanton nje porte komunikimi te sigurte te enkriptuar midis skanerit/skanerave SICPAMOBILE® dhe Serverit te aplikimit te Sistemit te Monitorimit te Gjurmës Qendrore dhe Shenjave.



Figura 33334 : Shembull i rafteve ruajtës dhe informatik te Sistemit te Monitorimit te Gjurmës Qendrore dhe Shenjave

7.9.4 Siguria

Matjet e sigurta te meposhtme do te perdoren me qellim per te mbrojtur te dhenat e mbledhura dhe transmetimin:

- Arkitektura e rrjetit me nen rrjete te ndara, firewalls dhe autorizime te Ministrise Shqiptare te Financave;
- Rrjeti virtual privat me transmetim te enkriptuar per komunikimin me nensistemet SICPATRACE®;
- Autenticiteti dhe menaxhimi i sesionit per te gjitha nensistemet (me perjashtim te aplikimit publik web);
- Transmetimi i enkriptuar per komunikimin me nensistemet e auditit;
- Komunikimi i enkriptuar per aplikimet Web;

- Enkriptimi i te dhenave te prekshme ne ruajtjen e te dhenave;
- Komunikimet e rrjetit te kontrolluara nga nje Sistem i Parandalimit te Nderhyrjes .

7.9.5 Vazhdimesia e Sistemit

Zgjidhjet e meposhtme do te perdoren me qellim per te siguruar gadishmeri te larte te Gjurmese Qendrore dhe Sistemit te monitorimit te Gjurmese:

- Zgjidhjet e hardwareve me te mire te mbajtur te cilet ofrojne nivel te larte te teprices hardware (njesite e furnizimit me energji, memoria e tolerances se gabimit, Hard Drives nen mbrojtjen RAID, Arkitektura Multi-CPU);
- Perdorimi i zgjidhjes se furnizimit me energji elektrike te panderprere (UPS);
- Zgjidhje suporti ne kaseta me kapacitet te larte per ta rregulluar plotesisht nga demtimet;
- RAID DAS (Ruajtja direkte e bashkengjitur) veshja e disqeve me nivel hardware te teprices (RAID) – ne rastin e prishjes se disqeve mund te zevendesohen online pa ndikimin e te dhenave;
- Serverat instalohen ne nje ambjent me ajer te kondicionuar .

7.9.6 Performanca

Zgjidhjet e meposhtme do te perdoren me qellim qe te sigurojne performance te larte te Gjurmese Qendrore dhe Sistemit te Monitorimit te Gjurmese:

- Zgjidhjet e hardwareve me te mire te mbajtur te cilet ofrojne performance te larte dhe stabilitet ;
- Arkitektura e hardwareve te shkallezuar per te rritur performancen online me irritjen e nevojave te projektit – shtese e infrastrukturese se pershtatshme te kerkuar;
- Zgjidhja e te dhenave te performances se larte te Ndermarries per te ruajtur te dhenat plotesisht edhe gjate fazave me ngarkese te rende;
- Zbatimi i Webit te drejtimit te tregut dhe Serverat e Aplikimit Middleware ne trajtimin e Sesionit Aktiv dhe sesionet e vogla te kohes se shperndarjes;
- Modeli i te dhenave te porositura dhe teknikat e grumbullimit te te dhenave per raportim.

7.9.7 Dizenjimi funksional i nderfaqeve te te dhenave

Gjurma Qendrore dhe Sistemi i Monitorimit te Gjurmës do te jetë i aksesueshem per perdorues te ndryshem te autorizuar nepermjet një nderfaqe të sigurte te klientit web duke lejuar funksionimin e sistemit dhe raportimin ne te gjithe aktivitetet. Te dhenat dhe specifikimi funksional i klientit web do te bien njekohesish dakord midis SICPA dhe Ministrise se Financave ne fazën e dizenjimit te zbatimit te sistemit. SICPA do te mbeshtese Ministrinë e Financave ne percaktimin e nevojave.

Figura me poshte ([Figura 34](#)[Figura 34](#)[Figura 35](#)) paraqet një fotografi te shembullit te ekranit te Gjurmës Qendrore dhe nderfaqes se klientit web te Sistemit te Monitorimit te Gjurmës.

Formatted: Font: 11 pt, Portuguese (Brazil)

Formatted: Font: 11 pt, Portuguese (Brazil)

The screenshot shows the SICPATRACE Data Management System interface. At the top, there's a header with the company name "SICPA Security Solutions S.A." and the system name "SICPATRACE® Data Management System". On the left, there's a sidebar with "WEBAPP MODULES" and "SESSION". The main area has a "USER SEARCH FILTER" section with fields for "Login", "Full Name", "User Role", and "Subsystem", along with "SEARCH" and "RESET" buttons. Below this is a table listing users:

Login	Full Name	Locked	User Region	Subsystem	User Role	Actions
admin	Administrator	no		DMS	Administrator	
masterpcc	Master PCC	no		Master PCC	System	
auth	Authority	no		Master PCC	Authority	
clerk	Clerk	no		Master PCC	Stamp Administrator(COM)	
mgr	Stamp Mgr A	no		Master PCC	Stamp Manager(COM)	
stadmin	Stamp Admin	no		Master PCC	Stamp Administrator(COM)	
pccpadi	PCC S2B	no		PCC S2B 1	System	
pccrel	PCC R2R	no		PCC R2R 1	System	
masteras	Master SAS	no		Master SAS	System	
sas1	SAS 1	no		SAS 1	System	

At the bottom of the table, there's a note: "Tip: Sort table by clicking on the headers." and a "CREATE USER" button.

Figura 34**34****35** : Sistemi i Monitorimit te Gjurmës Qendrore dhe Shenjave shembulli i nderfaqes se klientit web

Eksporti i te dhenave dhe nderfaqet

Te dhenat e permabjutura brenda te dhenave te Sistemit te Monitorimit te Gjurmës Qendrore dhe Shenjave i perkasin autoritetit.

Me qellimin per ta bere punen e Autoritetit te lehte eksporti i meposhtem dhe mundesite e integrimit Jane shperndare si pjese e sherbimit:

1. Klienti web i Sistemit te Monitorimit te Gjurmës Qendrore dhe Shenjave perfshin veçorite e eksportit te te dhenave duke lejuar eksportimin e cdo raporti drejtperdrejtë brenda PDF ose MS Excel sic tregohet ne shembullin e raportit te meposhtem ([Figura](#)

Formatted: Font: 11 pt, Italian (Italy)

35Figura 35Figura 36:

Formatted: Font: 11 pt, Italian (Italy)

STAMP PRODUCTION

Year / Month	Start > End
Year	2008
Month	All
Site	All
VIEW REPORT	

[PDF Version](#) [Excel Version](#)

Year	Month	Tobacco import	Alcohol	Non alcoholic	Total
2008	January	89'155	738'078	322'871	1'147'806
	February	87'404	650'491	299'890	1'000'785
	March	89'155	738'078	322'871	1'147'906

Figura 353536 :Shembull i raportit me eksport PDF dhe XLS

2. Per me teper nese kerkohen me shume eksportet te detajuara ato do te miratohen midis Autoritetit dhe SICPA dhe do te dorezohen ne formatin e miratuar ;
3. Sistemet e jashtme mund te integrohen sigurisht ne Sistemin e Monitorimit te Gjurmës Qendrore dhe Shenjave nepermjet nderfaqeve te jashtme te programuara.

SICPA do te bjere dakord me Autoritetin ne vendosjen e roleve te ndryshme me te drejta specifike qe do te zbatohen brenda sistemit. Enti i Autoritetit perqejges per projektin do te jape listen e perdoruesve te autorizuar nga cdo pale e interesuar (MF, DPT, DPD, etj.) me rolet dhe te drejtat e tyre specifike dhe raportet specifike per te cilat ata jane te autorizuar te konsultohen.

7.9.8 Periudha e ruajtjes se drejtperdrejte

Sistemi i Monitorimit te Gjurmës Qendrore dhe Shenjave garanton ruajtje te sigurte duke dhene akses te drejtperdrejte per nje periudhe prej pese (5) vjetesh me mundesine per te terhequr te dhenat e arkivuara ne shirita per dhjete (10) vitet e fundit bazuar ne supozimet e meposhtme: Numri mesatar vjetor i Pullave Fiskale qe perdoren ne produktet e duhanit te importuara ne Shqiperi : 240 milion Pulla Fiskale,

1. Numri mesatar vjetor i Pullave Fiskale qe perdoren ne pijet alkolike si te importuara apo te produhuara ne Shqiperi: 3 Milion Pulla Fiskale,
2. Numri mesatar vjetor i Pullave Fiskale qe perdoren ne pijet e veres si te importuara ose te produhuara ne Shqiperi: 3 Milion Pulla Fiskale,
3. Numri mesatar vjetor i Pullave Fiskale qe perdoren ne pijet e rakise si te importuara ose te produhuara ne Shqiperi: 400,000 Pulla Fiskale,

4. Numri mesatar vjetor i kodeve qe aplikohen per njesite e paketimit te birres ne Shqiperi: 90,000,000 gjurme¹ kontrolli,
5. Numri mesatar vjetor i Pullave Fiskale te importurara qe aplikohen per njesite e paketimit te birres te importuara ne Shqiperi: 35,000,000 gjurme kontrolli,

7.9.9 Aftesite e Hardware dhe software

Brenda Sistemit te Monitorimit te Gjurmese Qendrore dhe Shenjave kerkesat baze jane parashikuar drejtperedrejtne ne vellimin e Pullave Fiskale me baze vjetore. Kjo ka nje ndikim te drejtperedrejtne ne kerkesat e ruajtjes, fuqine e procesit, hapesireni fizike dhe perqatitjen e rrjetit. Ne varesi te konfigurimit perfundimtar te te gjithe struktura, duke perfshire numrin e kodit dhe vendet e aktivizimit.

Ne do ti kryejme keto llogaritje duke u bazuar ne zbatimet tone industriale dhe stimulimet laboratorike, dhe me pas sigurojme se dy (2) here cdo element kapaciteti eshte ne dispozicion per shpime te mundshme ne volumet e prodhimit ose ne situata te tjera pafavorshme.

Per me teper Sistemi i Monitorimit te Gjurmese Qendrore dhe Shenjave eshte percaktuar per te lejuar perhapjen e shpejte ne linje me rritjen e projektit. Me nje infrastruktura lethesuese te percaktuar rrjet procedura nepermjet shtimit te burimeve dhe kompleksitetit te zgjidhjeve te zbatuara duke perfshire zbatimin e mundshem te teknologjive te grumbullimit, rrjetet e zonave te ruajtjes dhe infrastrukturen e rrjetit te teper/te fuqishem.

Platforma SICPATRACE® do te disenjohet dhe zbatohet duke perdonur modulet e standartizuara dhe fleksibilitetin e targetuar duke lejuar zbatimin e kostos efektive te ndryshimeve te vogla nepermjet kohezgjatjes se kontrates dhe zbatimi i shpejte mbeshtetes i shtesave te sigurta.

Ndryshimet kryesore qe prekin ndryshimet strukturore te sistemit ose modifikimin e hardwerit do te kerkojne nje analize rast pas rasti dhe mund te ndodhin kosto shtese te cilat diskutohen dhe miratoohen midis SICPA dhe Ministritse Shqiptare te Financave.

7.10 Permiresimi dhe zevendesimi i pajisjes

SICPA do te kryeje te gjitha permiresimet dhe zevendesimet e pajisjes te nevojshme per te siguruar nje Nivel Sherbimi qe i pershatet Niveleve te Sherbimit te paraqitura ne Aneksin 5 te kesaj kontrate.

¹ Vleresimi vjetor i bazuar ne prodhimin e 2008 dhe vleresimet e importit te dhena nga MF. Eshte vleresuar se 70% e prodhimit vendas eshte shitur ne shishe ose kuti me mase mesatare 0.41.

7.11 Perhapja e mundshme te Produktet Farmaceutike

7.11.1 Monitorimi i prodhimit, importimit dhe distribucionit te Produkteve Farmaceutike

Me qellim qe te sigurohet monitorimi i prodhimit, importimi dhe shperndarja e produkteve farmaceutike ne Shqiperi SICPA propozon nje Pulle Fiskale farmaceutike te re te permiresuar duke perfshire nje kod SICPADATA® te padukshem.

6. Dokumentacioni


Te gjitha detajet e udhezimeve te kerkuara do te garantohen gjate periudhes se zbatimit:

1. Udhezimet e zbatimit per industrine me shpejtesi te larte industriale, prodhimin me volum te ulet dhe produktet e importuara aplikojne Pullen Fiskale per Alkolin dhe Duhanin; dhe ne nje faze te dyte per Produktet Farmaceutike;
2. Gjurma dhe udhezimet e Sistemit te Gjurmes dhe manualet e funksionimit;
3. Udhezimet cilesore dhe proceset;
4. Udhezimet e sigurta;
5. Manualet e Mirembajtjes dhe Funksionimit .


2. Scan or type the  as shown in the screen below.



3. Scan or type the  as shown in the screen below.



4. Scan or type all  EPC codes  as shown in the screen below.



5. After scanning all the  click the SAVE AND CLOSE button.

Figura 363637 : Shembull i manualit te funksionimit

7. Funksionimi i sistemit

SICPA do te ndertoje ne Shqiperi nje Sherbim vendor te Klientit dhe nje ent Funksionesh ("CSO"). Kjo strukture do te mbeshtese instalimin e pajisjes ne bashkepunim te ngsuste me mbeshtetjen e zyres se SICPA dhe ekipet teknike, dhe do te jetë perggjegjese per funksionet dhe miremajtjen menjehere apo vendoset sistemi SICPATRACE®.

SICPA ka nje reputacion te njohur sherbimi klienti dhe funksionim shume te mire dhe punon shume per te arritur dhe mirembajtur kete reputacion. Ne kete kapitull, ne japim nje pamje te perggjithshme te perggjegjeseve te Sherbimit vendor te Klientit dhe organizimit te Funksioneve, duke perfshire funksionet, sherbimet e siguruara, garancite dhe mirembajtjen.

Misioni i Funksioneve dhe Sherbimit vendor te Klientit SICPA

Sherbimi vendor i Klientit SICPA dhe organizmi i Funksioneve do te ndertohet apo te njoftohet qe ky projekt na eshte dhene ne. Sic ne do te shohim me vone ne kete kapitull, Sherbimi i klientit dhe Funksionet do te perfshijne rreth 20 njerez. Misioni i tij eshte dy-pjesesh:

1. Mbeshtetja e ekipeve te instalimit gjate pozicionimit te mjeteve duke siguruar tekniket perkates dhe mbeshtetjen logistike vendore.
2. Siguron funksionet e zbutura te SICPATRACE® te instaluar nepermjet kohezgjatjes se kontrates.

SICPA do te garantoje sherbimet e meposhtme teknike ne te gjitha vendndodhjet te cilat jane dizenjuar per tu pajisur pajisjen specifike SICPA:

- Siguron operatore per te drejtuar makinerite perkatese per kodimin e Pullave Fiskale sic kerkohet nga Ministria e Financave;
- Siguron specialistet e duhur per te riparuar/ose zevendesuar pjeset e demtuara te sistemit (mirembajtja korriguese);
- Telefoni i linjes se ndihmes dhe mbeshtetja teknike me e-mail;
- Menaxhon inventaret dhe skajet logistike me qellim per te minimizuar kohen e humbur te makinerise;
- Kryen pune rutine te mirembajtjes parandaluese ne te gjitha pjeset e Sistemit ku disa pune rutine jane te aplikueshme;

- Kryen permiresimet e sistemit ;
- Teston dhe shperndan ndryshimet ne sisteme (nga kerkesat e ndryshuara)
- Perdorimi dhe realizimi i sistemit te Monitorimit te (PCC, SAS, SCL, Sistemi i Monitorimit te Gjurmës Qendrore dhe Shenjave, AS);
- Personeli i trajnuar i peractuar per te perdorur sistemin.

Sherbimi i klientit dhe Organizimi i funksioneve per Shqiperine




Figura 373738 : Sherbimi i klientit dhe organizimi i funksioneve

Menaxheri CSO eshte plotesisht perjegjes per funksionimin e sistemit SICPATRACE®. 4 funksione kyc (ose ekipe) i raportojne atij:

Funksioni i Kodimit: Pergjegjes per kodimin e Pullave Fiskale. Funksioni kodues eshte organizuar si një njesi prodhimi, me një lider prodhimi ose menaxher prodhimi ne varesi te permases se organizimit. Operatoret kodues jane perjegjes per funksionimin e PCC ose pajisjet kondicionuese (makineria mbeshtjelles, sistemi i kutise) dhe mbeshteten nga asistentet kodues qe levizin materialin (furnizoje PCCs me fleta te printuara dhe sjellin fletet e koduara per kondicionim). Nese kerkohet me shume se një turn, drejtuesit e turnit do ta raportojne me pas tek drejtuesi i prodhimit (ose menaxheri i prodhimit).

Mirembajtja e pajisjes: Ky ekip eshte perjegjes per te siguruar mirembajtjen korrigjuese parandaluese te nivelit te pare dhe te dyte per te gjitha pajisjet SICPATRACE®, me perjashtim te Sistemit te Monitorimit te Gjurmës Qendrore dhe Shenjave dhe disa aplikimeve shume specifike mbeshtetese. Inxhinieret e sherbimit dhe tekniket e sherbimit jane trajnuar ne mirembajtjen parandaluese te PCC, SAS dhe SICPAMOBILE® dhe jane te afte te rregullojne incidentet e raportuara per PCC, SAS dhe SICPAMOBILE®. Nese materiali i demtuar nuk mund te rregullohet ne vend, ata e dergojne per rregullim ne dyqanin e riparimit i ndodhur ne zyren vendore kryesore. Nese nevojitet një nivel i trete mbeshtetjeje, me pas ai shkallezohet tek Ekspertet e SICPA Experts ne HQ.

Sherbimi IT: Ky ekip eshte perjegjes per Sistemin e Monitorimit te Gjurmës Qendrore dhe Shenjave, infrastrukturen e rrjetit dhe disa aplikime specifike te mirembajtjes se nivelit te pare dhe te dyte. Ekipi perbehet nga specialistet e rrjetit, specialistet e sigurise IT, administratoret e te dhenave dhe specialisti mbeshtetes i aplikimit. Ky ekip eshte gjithashtu perjegjes per Service Desk dhe prandaj ka operatoret service desk. Ai do te hartoje gjithashtu nga te dhenat e paperpunuara treguesit e realizimit te projektit (projekti KPIs).

Mbeshtetja e procesit: Pergjegjesia kryesore e ketij ekipi eshte te mbeshtese 3 ekipeve e tjera per proceset, procedurat dhe udhezimet e punes te pershtatura per funksionin e vendit. Ata mbeshteten nga SICPA CSO te HQ ne termat e metodologjive dhe proceseve globale, procedurave dhe udhezimeve te punes. Inxhineri i procesit do te pershtase gjithashtu planin e cilesise per funksionin e vendit. Ai do te drejtoje procesin 8D (procesi i investigimit te problemit per te adresuar shkakun kryesor). Pergjegjesia e ketij ekipi eshte gjithashtu ne ndryshimin e menaxhimit (me nje ndryshim koordinatori kur funksionimi eshte domethenes), kontroll dokumenti (prosesi, procedura regjistrime ...) dhe do te koordinoje trajnimin me ekipin CSO HO (ose me nje trajnues teknik ose me nje koordinator trajnues).

Mirembajtja

Mirembajtja sigurohet ne dy situata:

- Mirembajtja korriguese per riparimet e demtuara/te caktuara
- Mirembajtja parandaluese per te siguruar drejtimin e zbutur te Sistemeve

Mirembajtja korriguese

Mirembajtja korriguese ndodh kur degradimi ose humbja e sherbimit ndodh ne ndonje pjese te SICPATRACE. Mirembajtja korriguese me pas do te sigurohet nga specialistet tane me qellim qe te restaurohet sherbimi. Mirembajtja korriguese do te zbatohet ne perputhje me Nivelet e Sherbimit te percaktuara ne Aneksin 5 te kesaj kontrate.

Mirembajtja parandaluese

Me qellim qe te siguroje eficence optimale te pajisjes se parashikuari, mirembajtja parandaluese do te programohet mbi nje baze te rregullt.

Kur specifikohen disa detyra te mirembajtjes baze perfshijne pastrimin e rregullt nen perjegjesine e vete operatoreve te linjes, duke ndjekur trajnimin e tyre dhe ne perputhje me dokumentacionin e derguar.

Kontrolllet e plota te pajisjes do te realizon sipas nje baze te rregullt me qellim qe te minimizojne ndikimin mbi prodhimin.

Zakonisht, programi i mirembajtjes se SICPA eshte i sinkronizuar me planin e mirembajtjes se prodhuesit, keshtu lejon qe mirembajtja e pajisjes SICPA eshte kryer gjate periudhes kur linja nuk prodhon.

Menaxhimi i thirrjes

Per te minimizuar kohen e humbur te makinerise kur problemet ndodhin kerkohet nje organizim dhe mjete te zbatimit te larte dhe nje metotologji e provuar.

Ne Shqiperi SICPA do te zbatuje standartet e saj, procesin e provuar per thirrjet e trajtuar nga nje prodhues kur eshte kerkuar mirembajtja korriguese. Ky proces eshte si vijon.

Desk Service – Veshtrim i pergjithshem

Te gjitha thirrjet per mirembajtjen korriguese do te behen ne service deskun tone nepermjet hotline contact info.

SICPA's service desk do te regjistroje cdo thirrje dhe do te vleresoje pergjigjen me te mire sipas disa parametreve kryç:

- Lloji i problemit
- Ndikimi ne prodhim
- Vendndodhja e linjes prodhuese
- Gadishmeria e specialistit
- Disponueshmeria e pjeseve te kembimit
- Mjetet e transportit

Sherbimi service desk eshte nje mjet i fuqishem i cili e ka vertetuar eficencen e tij tashme ne vende te tjera atje ku ne kemi vendosur sistemet dhe teknologjite tona. Sistemi service desk do te jet ne gjendje te beje monitorimin e thirrjeve sipas parametreve kryç sic tregohet ne figuren me poshtë:




Figura 383839 : Veshtrim i Pergjithshem i sistemit Helpdesk

Sistemi service desk SICPA mundeson nje menaxhim eficent te parametrave kyc te meposhtem:

- Siguron nje kohe te shpejte per gjigjeje dhe riparimi.
- Regjistron dhe shenon cdo thirrje dhe e ndjek derisa thirrja te perfundoje.
- Regjistron parametrat perkates te cdo thirrjeje me qellim per te mirembajtur statistikat dhe raportimin.
- Programon dhe zgjedh mirembajtjen parandaluese ne sinkronizim me kerkesat e prodhuesit.
- Vlereson specialistin e duhur te kerkuar ne perputhje me listen e detyrave dhe ish thirrjet e mbetur ne priteje dhe drejtimet e aftesise se kerkuar.
- Shkallezon automatikisht thirrjen kur veprimet e pritura nuk kryhen ose nuk dergohen rezultate sipas parametrave te paracaktuara (shih seksionin tjeter)
- Lidh pershkrimin e problemit me bazen e njohurive tona globale me qellim qe te keshilloni zgjidhjen teknike me te pershtatshme dhe keshtu te minimizoni kohen e riparimit dhe kohen e humbur.

Menaxhimi i thirrjes eshte ilustruar me figuren e meposhtme (Figura 40).




Figura 393940 : Mirembajtja e menaxhimit te thirrjes

Procesi i Shkallezimit

Ekspriencia e fushes se SICPA-s ka treguar se here pas here disa ceshtje specifike nevojitet te shkallezohen me qellim qe te shmangen periudhat te gjata perpara se te perfundoje nje thirrje. Prandaj ne kemi zhvilluar nje process shkallezimi i cili eshte integruar sistemit tone service desk. Shkallezimi eshte bere automatikisht sipas parametrave te paracaktuara ne sistem.

Ka dy nivele te ndryshme shkallezimi:

- Nese nje inxhinier sherbimi ka veshtiresi ne zgjidhjen e nje ceshtje brenda 4 oreve, ai duhet te shkallezoje thirrjen tek specialistet vendor te SICPA-s duke ndjekur shkallezimin e nivelit te pare.
- Nese gjithashtu specialisti vendor i SICPA-s nuk eshte ne gjendje te zgjidhe ceshtjen brenda 4 oreve, ceshtja do te shkallezohet automatikisht ne mbeshtetjen e nivelit te detyre ne Seline tone. Procesi i shkallezimit gjithashtu do te informoje automatikisht menaxheret perkates nepermjet e-mailit ose SMS-ve ne perputhje me parametrat e paracaktuara dhe sic ilustrohet me figuren e meposhtme ([Figura 40](#)[Figura 40](#)[Figura 41](#)).




Figura 40[Figura 40](#)[Figura 41](#) : Programi i shkallezimit Automatik

Aneksi 4 – Dizenjot e pullës

- 1. Prova e printimit dhe ndryshimet ne dizenjo**
 - 1.1 Koncesioneri do te siguroje provat ("**Provat e Printimit**") per çdo lloj tipi te pullës fiskale. Çdo prove printimi do te miratohet dhe firmoset nga Autoriteti para prodhimit te tipit përkatës se pullës fiskale.
 - 1.2 Çdo Dizenjo e paraqitur ne këtë aneks është një dizenjo fillestare dhe mbetet subjekt i rishikimit. Përveç përditësimit te rregullt ne dizenjon e printimit te pullës per cdo dizenjo një here ne çdo dy vjet, dhe ndryshe siç parashikohet shprehimisht këtu, ndryshimet e dizenjos te përcaktuara këtu janë subjekt i Procedurës se Kontrollit te Ndryshimit.
- 2. Dizenjot fillestare**

Shih shtojcën 1 deri 8 ketu. Dizenjo per Pullat Fiskale per Produktet Farmaceutike i percaktuar ne Shtojcen 7 eshte dizenjim paraprak dhe mund te ndryshoje per sa i perkthet permbajtjes dhe ngjyres. Palet do te bien dakort mbi Dizenjon finale per Pullat Fiskale per Produktet Farmaceutike brenda 1 muaji pas Dates se Ekzekutimit.

Aneksi 5 - Nivelet e Sherbimit

1. Te pergjithshme

Ky Aneks paraqet një pershkrim te Organizimit te Sherbimi te Klientit ("OSK") I parashikuar ne daten e kesaj Marrveshje. Koncessioneri mund te rregulloje strukturen e OSK kohe pas kohe gjate Afatit per te reflektoar ndryshimet ne kerkesat e praktikave me te mira.


2. Vendndodhjet

OSK eshte planifikuar rrith tre qendrave kryesore : **Tirana, Vlorë dhe Korçë**.

Tirana: Selia e Koncesionerit dhe zyra qendrore e OSK. Koncessioneri do te perzgjedhe vendodhjen specifike ku do te hape zyren kryesore te OSK ne Tirane duke u konsultuar me Autoritetin. Kjo zyre do te mbeshtese linjat e vendosura ne Tirane, te ekzekutoje mirembajtjen e paisjeve SICPAMOBILE®, te ekzekutoje mirembajtjen dhe funksionimin e Sistemit te Monitorimit te Gjurmave dhe Shenjave, te ekzekutoje mirembajtjen e PCC dhe te koordinoje 2 ekipet e tjera ne Vlore dhe Korçë. Zyra kryesore e Tiranës do te mbikeqyre:

- Sherbimin IT
- Servisin
- Qendren e Riparimit
- Proseset dhe Cilesine Lokale
- Mirembajtjen e Paisjeve per te gjitha vendodhjet dhe linjat ne rajon,

Skema e meposhtme praraqet strukturen e organizimit te parashikuar per kete operim.



Shenim: Organizimi OSK eshte per ilustrim por numri dhe perberja mund te ndryshoje qe ti pershatet ndryshimeve lokale ne menyre qe te siguroje sherbimin me te mire.

Figura 1 : Struktura e Parashikuar e Organizates

3. Programi i Mirembajtjes Parandaluese

3.1 Qellimi

Me nje numer veprimesh te programuara mbi paisjen e perdonur nga inxhinieret dhe tekniket e Koncesionerit, numri i incidenteve ne lidhje me paisjen SICPATRACE do te minimizohet.

Programi i mirembajtjes parandaluese SICPA (the "PMP") eshte i organizuar ne nivele sic pershkruhet ne tabelen e meposhtme.

Niveli i Mirembajtjes	FREKUENCA	VEPRIMET	IMPAKTI	KRYER NGA
Ditor	Ditor	Pastrim i sensoreve, kembezave, kokave te printerave	Asnjë impakt	Operatoret e trajnuar te linjes/paisjes dhe/ose tekniket SICPA
Afatmesem	600 h ose kur kerkohet	Kontrolli dhe/ose zevendesimi i lengjeve , vertifikim i viskozitetit, rregullim i parametrave software.	0- 2h*	Tekniket SICPA
Afatgjate	3 vjet / 5 vjet	Shkembim i komponenteve qe nidkojne ne saktesine e sitemit.	1-2 dite*	Exkskluzivisht tekniket SICPA

* Te ekzekutohet kur eshte e mundur jashte orarit te prodhimit te linjes/paisjeve.

3.2 Skeduli PMP dhe planifikimi vjetor

Skeduli i planifikuar PMP per cdo Vit Marrevshje do te programohet dhe do t'i komunikohet Autoritetit (i cili do t'ia komunikoje kete skedul prodhuesve te Produkteve) ne baze vjetore.

3.3 Pjeset e kembimit dhe stoqet

Koncesioenri do te mbaje nje numer te mjaftueshem pjesesh kembimi dhe inventar per te siguruar kohen me te shpejte te per gjigjes ne rast incidentesh.

Koncesioneri do te siguroje "reafte te siguruara" qe do te instalohen ne cdo fabrike per te ruajtur shumicen e pjeseve te kembimit ne vendndodhje. Nese kushtet mjedisore ne

fabrike jane te favorshme (temperatura dhe lageshtira), Koncesioneri do te vendose inventarin e te konsumueshmeve (boje, MEK) ne vendndodhje. Perndryshe , keto pjese kembimi dhe inventari do te mbahen ne zyren e Koncesionerit.

4. Mirembajtja Korrektive per linjat dhe mjetet


Objektivi i mirembajtjes korrigjuese eshte te minimizoje impaktin mbi prodhimin dhe perdorimin e skanerit si pasoje e keqperdorimeve ne sistemin SICPA.

Mirembajta korrektive tek linjat e prodhimit plotesisht automatike :

Mirembajtja korrektive tek linjat e prodhimit plotesisht te automatizuara do te zbatohet ne 2 nivelet e meposhtme:

- Me anen e nderhyrjes “ne vendndodhje”. Nese nuk asnje nga tekniket e Koncesionerit nuk eshte present ne shehin e prodhimit kur ndodh nje aksident, prodhuesi mund:
 - Te telefonoje servisin e SICPA, i cili do te caktoje nje specialist te shkoje ne venndodhje kur nuk ka asnje zgjidhje tjeter. Ne verejme se cod operator i prodhuesit mund te trajnohet per te kryer operacionet baze ne sistemet SICPA dhe kontrollet baze te sistemit.
 - Nese nje teknik ndodhet ne zone kur ndodh nje incident prodhuesi mund te kontaktoje teknikun direkt.
- Servisi SICPA. Servisi SICPA eshte nje kanal komunikimi direct midis prodhuesve dhe Koncesionerit (“**Servisi SICPA**”). Kur eshte e mundur, incidentet dhe defektet mund te adresohen dhe zgjidhen direkt me telefon me udhezime precise. Ne raste specifike, nje trajnim baze i kontrollit te sistemit SICPA dhe operacioneve baze mund t’i sigurohet cdo operatori te prodhuesit.

Shkembimi i pjeseve difektoze do te kryhet nga tekniket e Koncesionerit.



Mbeshtetja e prodhuesit per mirembajtjen dhe funksionimin:

Kreditet e Sherbimit do te rriten ne cdo muaj ne te cilin cilesia e me shume se 97.5% te Pullave Fiskale qe I jane shperndare Prodhuesve ne kete muaj ne perputhje me Aneksin 25 devijojne dukshem nga ana materiale nga cilesia e Kopjes Prove(ose Kopje Prove) qe lidhen me tipin (ose tipe) e ketyre Pullave Fiskale.

(f) Lexueshmeria e Pullave Fiskale

Kreditet e Sherbimit do te rriten ne cdo Muaj ne te cilin cilesia e me shume se 99% te Pullave Fiskale , qe jane porositur rregullisht nga Prodhuesit ne kete Muaj ne perputhje me Aneksin 25, nuk jane te lexueshem nga Skaneret Sicpamobile.

1.3 Perllogaritja e Krediteve te Sherbimit ; Rregullimi i Tarifes se Koncesionit

- (a) Kreditet e Sherbimit do te perllogariten ne baze vjetore. Krediti i Sherbimit e rritura ndonje Muaj per ndonje deshtim per te perm bushur nje Norme Niveli Sherbimi te specifikuar per kete Muaj ne pikat 1.2(a) deri (f) me siper do te jete nje shume e barabarte me 4,000 Euro.
- (b) Tarifa e Koncesionit e pagueshme nga Koncesioni ne lidhje me cdo vit Marreveshje ne perputhje me Nenin 17, sic percaktohet ne perputhje me Aneksin 18, do te rregullohet duke i shtuar asaj Kreditet e Sherbimit te shtuara per kete Vit Marreveshje (nese ka) te percaktuar ne perputhje me kete Aneks 11.
- (c) Pavaresisht ndonje klauzole tjeter te kesaj Marreveshje (duke perfshire cdo klauzole tjeter te ketij Aneksi 11) Kreditet e Sherbimit ne lidhje me cdo Vit Marreveshje ne asnje rast nuk dot kaloje EUR 200,000 per kete Vit Marreveshje.

1.4 Percaktimi i Pagesave te Vonuara

Nese, ne lidhje me cdo Objektiv te Shenjestruar, Certifikata perkatese e Arritjes se Objektivit te Shenjestruar nuk eshte leshuar ne lidhje me kete Objektiv te Shenjestruare ne perputhje me Aneksin 6 perpara ose ne Daten e Shenjestruar te parashikuar ne Aneksin 10 per kete Objektiv te Shenejstruar me pas, ne perputhje me Nenin 9, Pagesa e Vonuar e pagueshme nga Koncessioneri per Autoritetin ne lidhje me kete Vonese ne lidhje me kete Objektiv te Shenjestruar do te jete nje shume e barabarte me Euro 6,000 per cdo dite qe kalon

nga (por duke e perjashtuar) kjo Date e Shenjestruar (dhe qe perfshin) daten ne te cilen kjo Certifikate e Arritjes se Objektivit te Shenjestruar eshte leshuar; me kusht, qe nese kjo Certifikate e Arritjes se Objektivit te Shenjestruar nuk eshte leshuar perpara ose ne daten qe eshte 90 dite pas kesaj Date te Shenjestruar , nuk do te shtohen me Pagesa te Vonuara te metejshme ne lidhje me kete Vonese pas kesaj dite te 90-te .

Aneksi 12 - Garancia e Performances

Draft **[Ne perputhje me Kontraten]**

Date: [] 2020-01-15 2010

Garantuesi

Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë

Garancia e performances

N° Ref _____

Date _____

To : Ministria e Financave
Blvd Deshmoret e Kombit N° 4
Tirana, Republika e Shqiperise

Perderisa Koncesioneri ka marre pergjegjesi ne perputhje me marreveshjen [...] (referencat e koncesionit 11269-21-10-09) date [...] per te zbatuar nje sistem kontrolli te pullave fiskale ("Marrevshja");

Perderisa Marrevshja kerkon nje Garanci Bankare sipas formularit te Garancise se Performances ne Shumen e specifikuar prej EUR 1'000'000, si garanci qe detyrimet e parashikuara ne Marrevshje jane permbushur ;

Perderisa ne, Banka, [Qyteti], [Shteti], biem dakort te leshojme kete garanci;

Ne deklarojme se me anen e kesaj ne garantojme dhe marrim persiper ne menyre te parevokueshme t'ju paguajme ju cdo shume deri ne shumen totale maksimale prej EUR 1'000'000 (nje milion EURO), me marrjen e kerkeses se pare me shkrim te nenshkuar ne menyren e duhur ose me Swift te autentifikuar qe percakton se Koncesioneri nuk ka permbushur detyrimet e tij sipas Marrevshjes se siperpermendur.

Ne ju sigurojme me anen e kesaj garancie se nuk eshte e nevojshme ti adresoheni Koncesionerit fillimisht, ne menyre qe pagesa te kryhet sipas kerkeses suaj.

Ne deklarojme gjithashtu se asnje Aneks ose modifikim ne kushtet e Marrevshjes qe ju mund te beni me Koncesionerin, nuk na zhvesh ne nga detyrimet sipas kesaj Garancie.

Shuma e garantuar do te reduktohen nga cdo pagese e kryer nga ne si pasoje e nje Kerkese.

Garancia eshte e vlefshme 30 dite pas leshimit te Certifikates se Zgjidhjes [data do te percaktohet] por te pakten [dita e leshimit + 1 vit]. Ajo skadon plotesisht dhe automatikisht ne rast se Kerkesa juaj me shkrim per pagese, ne formularin e bashkengjitur ne Shtojcen 1ose Swiftin e autentifikuar, nuk do te jete ne dispozicionin tone ne adresen e mesiperme perpara ose ne daten e maturimit, pavaresisht nese kjo date eshte dite bankare ose jo.

Banka
[Qyteti], [Shteti]

Shtojca 1 e Aneksit 12

Formulari i kerkeses

Mbi letren me koke te Autoritetit

Per: [Emri dhe adresa e Bankes]

Ne vemandje te: [xxxx]

Garancia e Performances Nr: [xxx] dated [xxx](“Garancia”)

I nenshkuari si person i autorizuar ligjerisht i Autoritetit, verteton se:

1. kane dale rrrethanat te cilat ne perputhje me dispozitat e Marreveshjes (si percaktohet ne Garanci) i japin te drejte Autoritetit te beje nje Kerkese sipas Garancise; dhe
2. Data e Skadimit (sic percaktohet ne Obligacion) nuk ka ardhur.

Ne kerkime pagesen sipas Garancise te Performances te [xxxx] [ne fjale dhe shifra] qe eshte shuma qe na takon .

Ju lutem beni pagesen e kesaj shume ne llogarine [detajet e bankes dhe numri i llogarise qe do te plotesohet].

Me respekt

.....
ne emer dhe per llogari te Autoritetit

Aneksi 13 – Stafi Kyc/Kryesor

1. Qellimi

Qellimi i ketij Aneksi 13 eshte te percaktoje detyrimet e Koncessionerit ne lidhje me kerkesat specifike per Stafin Kyc.

2. Stafi Kyc

- 2.1 Koncessioneri do te jete perjegjes per te garantuar se lista e Stafit Kyc te perditesohet dhe t'i dergohet Autoritetit me ndryshimet qe i behen listes ne perputhje me Paragrafin 2 dhe ne perputhje me Nenin 26 te kesaj Marrevshje. Koncessioneri do te garantoje se Stafi Kyc do te mbetet i afte dhe me experience per te perm bushur detyrat gjate zbatimit te kesaj Marrevshje.
- 2.2 Autoriteti mund te udhezoje Koncessionerin te largoje ndonje prej Stafit Kyc ne perputhje me Nenin 26 te kesaj Marrevshje. Koncessioneri do te zevendesoje ndonje pre Stafit Kyc ne perputhje me kete Paragraf dhe Nenin 26 te kesaj Marrevshje.

3. Lista e Stafit Kyc

- 3.1 Lista e stafit kyc per zbatimin e projektit do te sigurohet nga Koncessioneri per Autoritetin perpara ose ne Daten e Hyrjes ne Fuqi.
- 3.2 Lista e stafit kyc per zbatimin e koncesionit do te sigurohet nga Koncessioneri per Autoritetin perpara ose ne Daten e Hyrjes ne Fuqi dhe do te perditesohen kohe pas kohe.

4. Detyrat Stafit Kyc Operacional

Detyrat e Stafit Kryesor do te jene si vijon:

Pozicioni	Tipi i profilit	Detyrat
Menaxheri i Pergjithshem	<ul style="list-style-type: none"> Te pakten 5 vjet eksperince ne nivel te larte dhe aftesi solide ne dorezimin e projekteve. Aftesi per te identifikuar nevojat kritike te biznesit dhe aftesite e lidershipit per te vene ne funksionim burimet, proceset dhe masat per te garantuar se objektivat e biznesit permbushen. Eksperience ne nje mjedis biznesi i orientuar nga menaxhimi i projektit Aftesi per te planifikuar per rritjen afatgjate ndersa drejtimi dhe shperndarja e nevojave te vazhdueshme eshte kritike. Orientim i forte drejt klientit mundesisht i shoqeruar me orientimin drejt shitjeve dhe marketingut. Kombinim i aftesive te shkelqyera nderpersonale, aftesi drejtuese, nivel i larte integriteti dhe orientim i forte drejt performances te cilin ai duhet ta induktoje tek ata te cilet 	<p>Pergjegjesi e pergjithshme per punen e ndermarre ne kete Marreveshje, duke perfshire:</p> <ul style="list-style-type: none"> Mbikëqyrjen e kesaj Marreveshje dhe menaxhimin financiar te angazhimeve. Aktivitet si percuesi kryesor i Koncesionit dhe te siguroje menaxhimin e lidhjeve te Koncesionit duke perfshire kontaktin me Autoritetin. Komunikim me drejtuesit ekzekutiv te Koncesionit per te siguruar trajtimin e ceshtjeve me rendesi kritike dhe negocimin e angazhimeve. Pjesemarrja ne aktivitete si Rishikimi i Vleresimit te Menaxhimit mbi cilesine e Koncesionit. Aprovimi i vendimeve te emerimit te stafit ne pozicionet kyce te ekipit.

Pozicioni	Tipi i profilit	Detyrat
	mbeshtesin biznesin.	
Menaxheri i Zinxhirit Furnitor	<ul style="list-style-type: none"> • Te pakten 5 vjet ne pozicione te ngjashme ne fushen e Zinxhirit Furnitor (mund te jetë si ne administrimin e shitjeve, blerje apo ne logistike) me perdorim intensive te ERP -se. • Rekomandohet fuqimisht formim Inxhinierik ose Teknik • Evidencia te provuara te kryerjes se aktiviteteve operacionale si ne Administrimin e Shitjeve, Prokurimit apo ne Shperndarje • Eksperiencia te provuara per te operuar efektivisht ne nje mjedis nderkombetar dhe multi-disiplinesh • Veshtrim i gjere i te gjithe procesit logistik • I afte te qendroje i fokusuar ne nje organizate te drejtuar nga ngjarja • Aftesi per te punuar ne nje mjedis te sapo krijuar dhe me te perfshihet ne nje organizim me te arriere • Te njohe paisjet e 	<p>Te kryeje cdo dite aktivite te Zinxhirit Furnitor duke perfshire: Menaxhimi i Porosive dhe Ndjekja, Menaxhimi i Magazines, Transportimi, Rregullimi i Import / Exportit, dhe Logistikën e kthimit.</p> <p>Ne me shume detaje kjo nenkupton:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Te lehtesoje procesin e importit dhe te veproje si person I autorizuar me Doganen Lokale, Derguesin, Furnitorin dhe Sicpa • Te organizoje lidhjen dhe dergimin e pasijve ne vendndodhje te ndryshme te vendit • Te ndjeke ngarkimin e mallrave deri ne shperndarjen e tyre, te ndjeke statusin e tyre dhe te marre masa ne rast problemesh • Te urdheroje menaxhimin nga perpunimi i kerkesave te klienteve dhe kuotimeve tek drejtimi i dergesave dhe perzgjedhja e transportuesve • Gjenerimin e te gjithe dokumenteve ne lidhje me dergesat <ul style="list-style-type: none"> ○ Faturat ose Formulare faturash ○ Listat e paketimit ○ Njoftimet per Mallrat e Rezikshme ○ Dokumentet te lohjistikes lokale ○ Dokumentet e eksport/importit • Te veproje ne perputhje me rregullat e brendshme te biznesit dhe procedurat si dhe kerkesat e import/eksportit

Pozicioni	Tipi i profilit	Detyrat
	zyres	<ul style="list-style-type: none"> Te hartoje dhe komunikojë parashikimet mujore te konsumit Te mbaje logistikën e kthimit per produktet difektoze, te teperta dhe MRO Te optimizoje proceset e shperndarjes & kostot
Finance dhe kontroll	<ul style="list-style-type: none"> Kontrollues finansiar me experience me te pakten 5 vjet eksperience ne finance dhe kontroll Brenda nje sherbimi nderkombetare / organizate e bazuar ne projekt. Aftesi te mira nderpersonale. Nivel i larte integriteti. Orientim drejt performances. Aftesi te shkelqyera analitike. Aktiv, te kuptoje mjedisin e biznesit dhe pritshmerite e vendit te punes dhe i oreinetuar drejt klientit. Gjuhet: Nivel shume i mire i Shqipes dhe Anglishtes. Talent per zgjidhjen e problemeve. Njohuri te mira te sistemit te taksave ne Shqiperi. 	<p>Pozicioni ka 4 perjegjesi kryesore;</p> <ul style="list-style-type: none"> Te jape asistence financiare dhe mbeshtetje gjate zbatimit te projektit; Te monitoroje CAPEX dhe shpenzimet operative gjate zbatimit dhe te siguroje perputhshmeri me shpenzimet e parashikuara ne buxhet Te drejtoje te gjitha aspektet financiare, raportuese, kontrolluese dhe kontabiliste te kompanise. Kjo do te perfshije mbeshtetjen e GM lokale per operimin ne Shqiperi dhe operimin brenda proceseve te rena dakord dhe sistemeve te ndarjes. Te mbaje kontakte me seline e SICPA Group dhe GSSD per te garantuar vazhdueshmeri ne procesin e planifikimit financiar, parashikimit dhe raportimit.
Menaxher i Sherbimit te	<ul style="list-style-type: none"> Diplome Bachelors 	<ul style="list-style-type: none"> Duke qene se eshte Pika e

Pozicioni	Tipi i profilit	Detyrat
Konsumatorit dhe Operacioneve	<p>ose eksperience ekuivalente pune ne Kryerjen e Sherbimeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> • 5 - 10 vjet eksperience ne nje pozicion te ngjashem. • Aftesi te shkelqyera lidershipi dhe aftesi nderpersonale, komunikues efektiv, inovativ dhe aftesi te mira influencuese. • Aftesi e provuar per te udhehequr e drejtuar nje specialist, nje ekip multi kulturesh me performance te larte Te percaktoje dhe komunikojte ne menyre te qarte drejtimin dhe standartet e performances per te siguruar qe i gjithe stafi eshte i motivuar per te arritur objektivat e biznesit. • Aftesi per te mbajtur qendrim te besueshem dhe pozitiv pune kur perballat me situata biznesi te tensionuara 	<p>Kontaktit, te menaxhoje llogarite e klientit per shperndarje zgjidhjesh/sistemesh .</p> <ul style="list-style-type: none"> • Te mbeshtese perdonimin e zgjidhjes/ sistemit nen mbikeqyrjen e Menaxherit te Projektit dhe Integrimin e Sistemit duke ndertuar, trajnuar dhe bere ekipin CS te disponueshem ne menyren e duhur . • Te krijoje dhe mbaje organizimin CS ne menyre qe te garantoje qe sherbimet CS te kryhen brenda buxhetit duke perm bushur objektivat e percaktuara tek SLA, KPIs dhe kerkesa te tjera kontraktuese dhe standarte operacionale te aprovuara. • Te garantoje qe prishmeria e klientit eshte perm bushur ose tejkalohet duke ndertuar marredhenie te forta te menaxhimit financiar. • Te krijoje dhe ruaje nje mjedis mbeshtetes per t'iu pergjigjur kerkesave te klienteve dhe raporteve te incidenteve; te percaktoje shkaqet kryesore per te ulur nivelet e raportit te incidenteve. • Te punoje me klientet per te zgjeruar e shtrire biznesin pertej niveleve ekzistuese. • Percaktoje, mbaje dhe mbikeqyre proceset per te garantuar perpunimin e porosive, faturimin dhe procedurat e tjera tregtare jane kryer ne mbeshtetje te kontratare . • Te krijoje dhe menaxhoje rrjete te jashtme dhe rregullime per te siguruar burime kontraktore dhe sherbime per te perm bushur kerkesat e kontrates me kostos me efektive.

Pozicioni	Tipi i profilit	Detyrat
		<ul style="list-style-type: none"> • Hartoje, permiresoje dhe te miratoje standartet e performances per ekipin vendas te veprimtarise teknike. • Te garantoje qe te dhenat dhe arkivat ruhen per te mbeshtetur kerkesat e biznesit. • Te asistoje ekipet e tjera CSU ne permiresimin e standardeve dhe procedurave te tjera globale CSU.

Aneksi 14 – Linjat e Prodhimit ne Shqiperi

1. Lista e Linjave te Prodhimit Fillestar

Me poshte jepet lista e fabrikave te pajisura me nje numer linjash te automatizuara tek te cilat nje system i automatizuar do te instalohet (SAS per Alkolin dhe SCL per birren).

Nr.	Numri i regjistrimit	Produkti	Emri i subjektit	Qyteti	Addresa	Numri i linjave
1	J61807020V	Pije Alkolike	AQUILA LIQUORI	TIRANË	Tiranë	1
2	J64103004E	Birre	BIRRA KORCA	DTM	Korcë Korçë KORÇË FAN NOLI	1
3	J61821051F	Birre	BIRRA TIRANA	DTM	Tiranë Tirana TIRANË RR. KAVAJËS	4
4	K36325201S	Birre	NORGA.	VLORË	Vlorë Vlorë VLORË L. 11 JANARI	2
5	K02406001S	Birre	STEFANI&CO	DTM	Tiranë Tirana TIRANË MEZEZE	3
6	K01331014I	Birre	STELA & DORINA	TIRANË	Tiranë Tirana TIRANË M GJOLLESHANPV USHTARAKE PRANË	3

2. Linjat e reja te Prodhimit Plotesisht te Automatizuara

Ne cdo kohe gjate Afatit, me kerkesen e Autoritetit, Koncesioneri do te instaloje pa pagese Paisjen Koncesionere perkatese tek Linjat e reja te Prodhimit Plotesisht te Automatizuara te rejat te Prodhuesve e Shkalles se Gjere ekzistues apo te rinj, me kusht gjithesesi, qe Koncesionerit do t'i jepet akses I sigurte ne ambientet dhe tek linjat e prodhimit te Produktit te ketyre Prodhuesve te Shkalles se Gjere.

Aneksi 15 – Procedura e Zgjidhjes se Mosmarrevshjeve

1. Hyrje

- 1.1 Te gjitha mosmarrevshjet do te zgjidhen ne perputhje me Proceduren e Zgjidhjes se Mosmarreveshjeve te percaktuar ne Aneksin 15.
- 1.2 Asgje ne kete Procedure Zgjidhje Mosmarreveshje nuk do te pengoje Palet te kerkojne nga cdo gjykate kompetente nje urdher te perkohshem per pengimin e Pales te tjeter ne kryrjen e ndonje veprimi ose ne detyrimin e pales tjeter ne kryerjen e ndonje veprimi.

2. Pershkallezimi

- 2.1 Nese lind ndonje Mosmarreveshje midis Autoritetit dhe Koncesionerit, palet do te perdonin te gjitha perpjekjet e arsyeshme per te zgjidhur kete Mosmarreveshje sa me pare te jete e mundur ne nivelin ne te cilin keto Mosmarrevshje lindin. Minimalisht, Palet do te garantojne se ato kane diskutuar ceshtjet perkatese ne baze te faktet perkatese, e kane pershkallezuar ate nepermjet niveleve operacionale, menaxhuese dhe ekzekutive te rishikimit (aty ku duhet) dhe kane perdonur te gjitha perpjekjet e arsyeshme per te rene dakort mbi zgjidhjen.
- 2.2 Nese nje Mosmarrevshje nuk mund te zgjidhet ne nivelin ne te cilen Mosmarrevshja ka lindur brenda nje afati te arsyeshem, cdo Pale mund ta drejtoje kete Mosmarrevshje tek niveli tjeter ne Procesin e pershkallezimit.
- 2.3 Cdo Mosmarreveshje qe nuk mund te zgjidhet brenda nje afati te arsyeshem ne nivelin ne Procesin e Pershkallezimit te cilit kjo Mosmarreveshje i drejtohet, kjo Mosmarreveshje do te drejtohet ne nivelin tjeter me te larte ose Arbitrimit ICC ne perputhje me Paragrafin 2.4.
- 2.4 Pervecse kur nje Mosmarreveshje kerkon nje zgjidhje te shpejte, ku operacionet e sejciles Pale jane ose mund te ndikohen negativisht, ose ku sejciла Pale mund te shkaktoje kostot te konsiderueshme ose humbje si pasoje e mos-zgjidhjes se Mosmarrevshjes, pershkallezimit te Mosmarrevshjes ne nivelin tjeter kerkon nje raport me shkrim nga Pala qe pershkallezon Mosmarrevshjen. Raporti do te permboje informacionin e meposhtem:
 - (a) emrin dhe adresen e biznesit te Pales qe ngre Mosmarreveshjen;
 - (b) daten ne te cilen eshte ngritur Mosmarreveshja;
 - (c) nje pershkrim te Mosmarrevshjes, duke perfshire cdo histori te problemeve te ngjashme;

- (d) implikimet e Mosmarrevshjes, serioziteti dhe niveli i emergjencës;
 - (e) një perllogaritje e kostos ekzistuese dhe potenciale të Mosmarrevshjes; dhe
 - (f) emrat dhe adresat e personave të tjere të perfshire të cilet duhet të konsultohen.
- 2.5 Brenda pese (5) Dite Pune te një vendimi nga secila Pale për pershkallezimin e Mosmarrevshjes, secila Pale do t'i siguroje tjetres një raport (qe permban të pakten informacionin e sipas paragraft 2.4 me siper) në të cilin kjo Pale parashtron pikepamjen e saj në lidhje me pershkallezimin e Mosmarrevshjes.
- 2.6 Menjehere pasi cdonjeri prej ketyre raporteve eshte siguruar, individet perkates ne nivelet perkatese do te kontaktojne njeri tjetrin sa me pare te jete e mundur ne menyre qe ta zgjidhin ate ceshtje qe i nenshtrohet pershkallezimit Brenda pese (5) Ditesh Pune nga marrja e ketij rapporti, deshtimi i leshimit te tij do te pershkallezohet ne nivelin tjeter.
- 2.7 Pavaresisht paragrafeve 2.4 deri 2.6 me lart, nese seicila Pale vendos me diskrecionin e saj se (i) Mosmarrevshja kerkon një zgjidhje te shpejtë (ii) operacionet e kesaj Pale mund te ndikohen negativisht ose (iii) kjo Pale mund te shkaktonte kosto te konsiderueshme ose humbje si pasoje e mos-zgjidhjes se Mosmarrevshjes, me pas kjo Pale mund ta referonte Mosmarrevshjen direkt ne ate nivel (duke perfshire Arbitrimin ICC) qe ajo Pale mendon se do te rezultonte ne zgjidhjen me te shpejtë te kesaj Mosmarrevshje.
- 2.8 Nivelet e pershkallezimit jane:

Niveli	Autoriteti	Koncessioneri
Niveli 1	Menaxheri i Projektit te Autoritetit	Menaxheri i Pergjithshem i SICPA Albania
Niveli 2	Zevendes Ministri i Financave i Republikës së Shqipërisë	Menaxheri kyc për projektin nga HoldCo
Niveli 3	Minsitri i Financave i Republikës së Shqipërisë	Bashke-Kryetari Ekzekutiv I Co
Niveli 4		Arbitrimi ICC

3. Arbitrimi ICC

Asgje ne kete aneks nuk do ti pengoje Palet te njoftojne njera tjetren me shkrim per vendimin per tu terhequr nga cdo procedure e referuar ne Paragrafin 2 te ketij Aneksi dhe te fillojne arbitrimin ICC ne perputhje me Nenin 66.

Aneksi 16 – Procedura e Ndryshimit te Kontrollit

1. Historiku

- 1.1 Aneksi 6 paraqet procedurat per tu marre me ndryshimet. Cdo Pale kryesore ne kete menyre:
 - 1.1.1 Verteton se ajo mund te jete e pershtashme per te leshuar nje kerkesa te vetme ndryshimi me baze tremujore per te mbuluar nje numer te vogel Ndryshimesh; dhe
 - 1.1.2 Pranon te veproje ne menyre te arsyeshme gjate gjithe kohes ne menaxhimin, propozimin, aprovimin dhe refuzimin e Ndyshimeve.

2. Garancia

- 2.1 Koncesioneri garanton, perfaqeson dhe merr persiper qe gjate Afatit do te mbaje burime te mjaftueshme per te menaxhuar dhe zbatuar Ndryshimet me shpejtesi dhe eficense. Palet e dine se menaxhimi dhe zbatimi i ndryshimeve jane ne vetvete sherbime per te cilat dispozitat e kesaj Marreveshje do te aplikohen.

3. Kerkesa e Ndryshimit

- 3.1 Secila Pale mund t'i leshoje nje Kerkesa per Ndryshim Pales tjeter ne cdo kohe gjate Afatit te kesaj Marreveshje. Nese Pala qe lehon Kerkesen per ndryshim e konsideron Ndryshimin si te jete nje Ndryshim i shpejte, Kerkesa per Ndryshim duhet gjithashtu ta theksoje kete fakt.
- 3.2 Sa me shpejt te jete e arsyeshme dhe e praktikueshme pas leshimit te Kerkeses se Ndryshimit por ne cdo rast jo me vone se pese (5) dite pune, palet do te mbajne nje takim per te diskutuar nje kerkesa te tille per ndryshim dhe te vendosin.
- 3.3 Nese Koncesioneri lehon Kerkesen per ndryshim, me pas ai duhet gjithashtu ti jape nje Vleresim Ndikimi Autoritetit sa me shpejt te jete e mundur, por ne cdo rast brenda pesembedhjete (15) diteve te punes, pervec rastit kur palet bien dakord ndryshe per daten e diskutimit te Kerkeses per ndryshim.
- 3.4 Nese Autoriteti lehon Kekesen per Ndryshim, atehere Koncesioneri do ti jape nje Vleresim Ndikimi Autoritetit sa me shpejt te jete e mundur ne menyre te arsyeshme, por ne cdo rast brenda dhjete (10) diteve pune nga data e marrjes se Kerkeses per Ndryshim me Autoritetin duke pasur parasysh qe, nese Koncesioneri duke vepruar ne menyre te arsyeshme kerkon ndonje sqarim ne lidhje me Kerkesen per Ndryshim perpara se ai te dorezoje Vleresimin e Ndikimi, atehere ai ne menyre te shpejte do te

njoftoje Autoritetin dhe periudha e kohes do te zgjatet nga koha e marre nga Autoriteti per te dhene keto sqarime. Autoriteti do ti pergjigjet kerkeses per sqarime sa me shpejt te jete e arsyeshme dhe e praktikueshme dhe Koncesioneri do ti garantoje Autoritetit informacionin e mjaftueshem per ti dhene mundesine atij te kuptoje plotesisht natyren e kerkeses per sqarim.

4. Procedura e testimit

Ne nivelin qe cdo Ndryshim kerkon testim dhe/ose nje program per zbatim, Palet do te ndjekin procedurat e paraqitura ne Aneksin 6. Nje Njoftim Leshues do te miratohet midis paleve dhe do te leshohet perpara shperndarjes se ndryshimit ne Ambjentin prodhues. Kur eshte e pershtatshme, Shenimi i Autorizimit te Ndryshimit lidhur me nje Ndryshim te tille do te specifikoje nje date dorezimi dhe perfundimi ne lidhje me nje ndryshim te tille per qellimet e ketyre procedurave.

5. Dispozita e Sherbimeve ne pritje te Njoftimit te Autorizimit te Ndryshimit

Gjate kesaj kohe qe Njoftimi i Autorizimit per ndryshim eshte nenshkruar dhe leshuar nga Autoriteti ne perputhje me paragrafin 8.1.4, atehere:

- 5.1.1 Pervec rastit kur autoriteti shprehet ndryshe me te shkruar, Koncesioneri do te vazhdoje te siguroje sherbimet ne perputhje me afatet ekzistuese te kesaj Marreveshje njesoj sikur ndryshimi te mos kishte ndodhur; dhe
- 5.1.2 Cdo diskutim, negociate ose komunikime te tjera te cilat mund te behen midis Autoritetit dhe Koncesionerit ne lidhje me cdo Ndryshim te propozuar, duke perfshire paraqitjen e cdo kerkese per Ndryshim, do te behet pa paragjykim nga detyrimet e tjera dhe te drejtat e seciles pale sipas kesaj Marreveshje.

6. Kostot

- 6.1 Bazuar ne paragrafin 6.3, secila pale do te mbarte kostot e veta ne lidhje me perqatitjen dhe marreveshjen e cdo Kerkese per Ndryshim dhe Vleresim Ndikimi, pervecse ne rastet kur palet bien dakord ndryshe midis tyre.
- 6.2 Koncesioneri do te kryeje Vleresimet e Ndikimit per Autoritetin pa pagese deri ne kufirin e pesedhjete (50) diteve ngarkese per Tremujor. Ky kufizim ne ngarkesen e burimimeve te Koncesionerit ne garantimin e Vleresimeve te Ndikimit perjashton ato Vleresime Ndikimi qe:
 - 6.2.1 Rezultojne ne Ndryshimet e miratuara nga Autoriteti; dhe
 - 6.2.2 Rrjedhin nga Ndryshimet e propozuara nga Koncesioneri.

6.3 Kostot e Autoritetit qe vijne ne lidhje me cdo perdonim te kesaj Procedure te Ndryshimit te Kontrollit, si rezultat i ndonje gabimi ose mosplotesimi nga Koncesioneri do te paguhet nga Koncesioneri. Kostot e Koncesionerit te ardhura ne lidhje me cdo perdonim te kesaj Procedure te Ndryshimit te Kontrollit si rezultat I ndonje gabimi ose mosplotesimi nga Autoriteti do te paguhet nga Autoriteti.

7. Vleresimi i Ndkimit

7.1 Cdo Vleresim ndikimi do te perfshije:

7.1.1 Studimin e fisibilitetit

7.1.2 Detajet e Ndyshimit te Propozuar qe perfshin arsyen per Ndryshimin;

7.1.3 Detajet e ndikimit te Ndryshimit te Propozuar ne Sherbimet dhe aftesine e Kocesionarit per te plotesuar detyrimet e tjera te tij sipas kesaj Marreveshje dhe cdo ndryshim ne afatet e kesaj Marreveshje qe do te kerkohet si rezultat I ketij ndikimi qe perfshin, ka kufizim, ndryshimet ne:

(a) Sherbimet dhe Nivelet e Sherbimit;

(b) Datat e Shenjestruara, Planin e Zbatimit dhe cdo program tjeter te miratuar me pare nga Palet; dhe

(c) Sherbime te tjera te garantuara nga palet e treta kontraktuese per Autoritetin, duke perfshire cdo Ndryshim te kerkuar nga Ndryshimi ne infrastrukturen dhe sistemet e teknologjise se Informacionit te Autoritetit ;

7.1.4 Detajet e kostos se zbatimit te Ndryshimit;

7.1.5 Detajet per kostot ne vazhdin nese ka, te kerkuara nga Ndryshimi kur zbatohet, duke perfshire cdo shtim ose zvogelim ne pagesa, cdo ndyshim ne burimet dhe/ose shpenzimet e kerkuara nga secila pale dhe cdo ndryshim ne praktiken e punes tek secila Pale;

7.1.6 Nje program per zbatimin, se bashku me cdo propozim per pranimin e Ndryshimit ;

7.1.7 Informacione te tjera te tilla qe Autoriteti mund te kerkoste ne menyre te arsyeshme (ose ne pergjigje te) Kerkeses per Ndryshim; dhe

7.1.8 Nje analize e risqeve qe vijne nga zbatimi i Ndryshimit dhe nje propozim si menaxhimi pro –aktiv i risqeve te identifikuara nga te dyja Palet

7.2 Nese Autoriteti eshte Pala Marrese dhe Autoriteti ne menyre te arsyeshme konsideron se ai kerkon informacion te metejsphem persa i perket Ndryshimit ne menyre qe ai mund te vleresoje ne menyre adeguate Kerkesen e Ndryshimit dhe Vleresimin e Ndikimit, atehere pas marrjes se fatures vijuese te Vleresimit te Ndikimit, do te njoftoje Koncessionerin per kete fakt dhe do te detajoje informacionin e metejsphem qe ai kerkon. Brenda dhjete (10) diteve pune nga marrja e nje njoftimi te tille, Koncessioneri do te ri lesjoje Vleresimin perkates te Ndikimit per Autoritetin. Ne maturine e arsyeshme te Autoritetit, Palet mund te perserisin procesin e pershkruar ne kete Paragraf derisa Autoriteti te jete i kenaqur qe ka informacion te mjaftueshem per te vleresuar ne menyren e duhur Kerkesen per Ndryshim dhe Vleresimin e Impaktit. .

8. Te drejtat e Autoritetit per Miratim

8.1 Brenda pesembedhjete (15) diteve pune nga marrja e Vleresimit te Ndikimit nga Koncessioneri ose brenda dhjete (10) diteve pune nga marrja e informacionit te metejsphem qe mund te kerkohet ne vijin te Paragrafit 7.2, Autoriteti do te vleresoje Kerkesen per ndryshim dhe Vleresimin e Ndikimit dhe duhet te beje nje prej pikave te meposhtme:

8.1.1 Te miratoje Ndryshimin, ne nje rast te tille Palet do te ndjekin proceduren e paraqitur ne Paragrafin 8.1.4 me poshte;

8.1.2 Ne maturine absolute te tij refuzon Ndryshimin, ne nje rast te tille ai do te njoftoje Koncessionerin per refuzimin. Nese Autoriteti refuzon nje ndryshim, ai me pas do te shpjegoje arsyet e tij me shkrim Koncessionerit sa me shpejt te jete e arsyeshme duke ndjekur kete refuzim; ose

8.1.3 Do ti kerkoste Koncessionerit te modifikoje Kerkesen per ndryshim dhe/ose Vleresimin e Ndikimit ne cdo rast Koncessioneri do te beje modifikime te tilla (referuar Paragrafit 7.2) brenda pese (5) diteve pune te kesaj kerkese. Me marrjen e Kerkeses se Modifikuar te Ndryshimit ose Vleresimit te Ndikimit, Autoriteti do te aprovoje ose refuzoje Ndryshimin brenda dhjete (10) diteve pune.

8.1.4 Nese Autoriteti aprovon Ndryshimin ne vijim te Paragrafit 8.1.1 dhe ai nuk eshte refuzuar nga Koncessioneri ne perputhje me Paragrafin 9.1 me poshte, me pas ai do te informoje Koncessionerin dhe Koncessioneri do te peruatise dy (2) kopje Njoftimit te Autorizimit te Ndryshimit te cilat ai do ti nenshkruaje dhe do t'ia dorezoje Autoritetit per nenshkrimet e tij. Fatura vijuese nga Autoriteti e Njoftimit te Autorizimit te Ndryshimit, ai do ti neshkruaje te dyja kopjet dhe ti ktheje nje (1) kopje Koncessionerit. Ne nenshkrimin e Autoritetit, Njoftimi i Autorizimit te Ndryshimit do te perbeje nje ndryshim detyrues ne kete Marreveshje duke garantuar se Njoftimi i Autorizimit te Ndryshimit nenshkruhet nga Autoriteti brenda dhjete (10) diteve nga marrja e kopjes se Nenshkruar te Koncessionerit. Nese Autoriteti nuk e nenshkruan Njoftimin e

Autorizimit te brenda kesaj periudhe kohe, me pas Koncesioneri do te kete te drejten te njoftoje Autoritetin dhe nese Autoriteti nuk e nenshruan Njoftimin e Autorizimit te Ndryshimit brenda pese (5) diteve pune nga data e ketij njoftimi, me pas Koncesioneri mund t'ia referoje ceshtjen Procesit te Shkallezimit.

9. Te drejtat e kufizuara te Koncesionerit per Miratim

- 9.1 Koncesioneri eshte i detyruar te zbatoje te gjitha Ndryshimet e kerkuara nga Autoriteti pervec kur , nese ndiqet nje Vleresim Impakti, Koncesioneri mund ta provoje, duke vepruar ne menyre te arsyeshme qe cdo Ndryshim i cili eshte kerkuar nga Autoriteti :
 - 9.1.1 Do te ndikoje materialisht dhe te kete ndikim negative ne risqet ne shendetin dhe sigurine e cdo personi: ose
 - 9.1.2 Do te kerkoste qe Sherbimet te kryhen ne nje menyre qe shkelin cdo ligj; ose
 - 9.1.3 Eshte jashte kapacitetit teknik te Koncesionerit sic kerkohet ne Kerkesat e Aneksit 2; ose
 - 9.1.4 Eshte provuar nga Koncesioneri, me bindjen e arsyeshme te Autoritetit, qe eshte teknikisht e pamundur per tu zbatuar,

Me pas Koncesioneri ka te drejten te refuzoje Ndyshimin dhe te njoftoje autoritetin per arsyet e tij per ta bere kete brenda pese (5) diteve pune nga data ne te cilen ai eshte i detyruar ta dorezoje Vleresimin e Ndikimit ne perputhje me Paragrafin 3.3 ose 3.4 (sic aplikohet).

10. Ndryshimet e gjurmave te shpejta

Nese te dyja palet bien dakord se nje Ndryshim duhet te klasifikohet si nje Ndryshim i i Shpejte me pas ata do ta shqyrtojne ate duke perdonur proceset e paraqitura ne Paragrafet e mesiperme por me shkalle kohe te reduktuar, ne menyre te tille qe cdo periudhe prej dhjete (10) ose pesembedhjete (15) dite pune reduktohet ne pese (5) dite pune dhe cdo periudhe prej pese (5) dite pune reduktohet ne tre (3) dite pune. Palet do te zbatojne nje Ndryshim I Shpejte qe autorizohet sipas rregullit ne perputhje me kete procedure sa me shpejte qe eshte e arsyeshme dhe e praktikueshme.

11. Komunikimi dhe Autorizimi i Ndryshimit

- 11.1 Cdo Ndryshim i perpunuar ne perputhje me kete Aneks nuk do te autorizohet dhe Koncesioneri nuk do te zbatoje asnje Ndryshim derisa Njoftimi i Autorizimit te Ndryshimit te nenshruhet dhe zbatohet nga Kryetari i Autoritetit te Strategjise IT ose

ne perputhje me Autorizimin e Ndryshimit te Autoritetit dhe procedurat e mbylljes, sic njoftohet tek Koncesioneri kohe pas kohe.

- 11.1.1 Per cdo Kerkese Ndryshimi qe te behet e vlefshme sipas ketij Aneksi, ai duhet te dorezohet ne perputhje me dispozitat e Nenit 63.

Shtojca 1 e Aneksit 16

Formulari i Kerkeses se Ndryshimit

Nr.CR	Titulli	Lloji i Ndryshimit
		[Gjurme e shpejte / Normale]
Projeki		Kerkuar nga data
Veprimi	Emri	Data
E ngritur nga:		
Zona, Zonat e ndikuara (fushe me zgjedhje):		
Caktuar per Vleresim Ndikimi nga :		
Caktuar per Vleresim Ndikimi per:		
Nr i references se Koncesionerit :		
Arritja e Ndryshimit:		
Pershkrimi i plete i Ndryshimit te Kerkuar (cfare, kush, kur, ku, cfare shpesh...):		
Detajet per cdo skenar alternativ te propozuar		
Arsyet per dhe perfitimet e Ndryshimit te Kerkuar		
Ndikimi i Projektit nese ndryshon nuk eshte bere:		

Nenshkrimi i [Pales] Zoteruesit te Ndyshimit te Kerkuar	
Data e kerkeses	
Data e Diskutimit midis Paleve	
Realizimi i Vleresimit te Ndikimit (Po/Jo)	
Koment	

Shtoja 2 e Aneksit 16

Formulari i Vleresimit te Ndikimit

Nr.CR	Titulli	Data:
Projekti	Kerkuar nga data	
Pershkrimi i detajuar i Ndryshimit per te cilin Vleresimi i Ndikimit eshte pergatitur dhe detajet e cdo Ndryshimi te lidhur me te		
Fisibiliteti dhe zgjidhja e propozuar:		
[Rregullimi i propozuar per Pergjegjesite qe rrjedhin nga Ndryshimi]		
Detajet e pergjegjesive shtese speciale te propozuara dhe mjetet per ti percaktuar ato(psh cmimi i vendosur ose baza e kostos plus)		
Detajet per cdo ndryshim te propozuar per kete Marreveshje		
Detajet per cdo Nivel Sherbimi te ndikuar		

Detajet e cdo ndikimi te sherbimit operacional	
Detajet e cdo nderfaqe te ndikuar	
Vleresimi i riskut i detajuar	
Rekomandimet	
Vleresimi I kohes se programit	
Nenshkruar nga []	
Vlersimi i Impaktit i realizuar nga :	
Firma:	Data:
Detaje shtese rreth vendimit (fushe me zgjedhje)	
Data e vendimit te Autoritetit:	
Vendim:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kerkese e ndryshimit e miratuar – Koncesioneri pergatit Njoftimin e Autorizimit te Ndryshimit [] 2. Kerkesa e Ndryshimit dhe/ose Vleresimi i Ndikimit per tu ndryshuar [] 3. Kerkesa e Ndryshimit e Refuzuar []
Komente – Arsyе:	

Shtojca 3 e Aneksit 16

Njoftimi i Autorizimit te Ndryshimit

CR Nr.	Titulli:	Data :	E ngritur nga :
Projekti	Kerkuar nga data		
Detajet e kerkesave per Ndryshim te lidhura dhe Njoftimet e Autorizimit te Ndryshimit			
Pershktimi i detajuar i ndryshimit – Specifikimi teknik			
Afatet e perllogaritura			
Detajet e etapave te zhvillimit dhe programit te zbatimit			
Detajet e cdo varesie (duke perfshire cdo hyrje te kerkuar nga Pala kerkuese)			
Detajet e Dorezimeve te perfunduara			

Detajet e cdo ndryshimi ne Pagesa		
Detajet e perjegjesive shtese speciale te propozuara dhe mjetet per ti percaktuar ato(psh emimi i vendosur ose baza e kostos plus)		
Detajet e cdo trajnimi te kerkuar te personelit (duke perfshire cdo dokument qe realizohet dhe cdo Procedure Testimi).		
Autorizimi i Ndryshimit (Po/Jo)		
Arsyeja:		
Autorizimi :		
Zgjidhje lokale ose globale:		
	Nenshkrimi:	Data:
	Nenshkrimi:	Data:
Detaje shtese rrreth vendimit (nese kerkohet)		
Kerkesa per punen/Numer Kuote	Numer urdhri	Njoftimi i perfundimit

Aneksi 17 – Trajnimimi

1. Hyrje

Qendrimi i trajnimit SICPA eshte ideuar per te siguruar qe cdo perdorues ose operator i autorizuar te jete njohur me metodologjite e autentifikimit te Pulles Fiskale si dhe pajisjet dhe makinat e autentifikimit specifike. Operatoret jane trajnuar per te vepruar ne menyre efektive dhe eficente me pajisjet e aplikimit .

Trajnimi per gjithesisht arrihet nepermjet perdorimit te sesioneve te trajnimeve ne vend dhe programeve arsimore te bazuara ne materialet udhezuese vizuale.

Zgjidhja e SICPATRACE® perfshin shume shtresa sigurie qe mund te verifikohen edhe nga syri njerezor ose nga pajisje specifike zbuluese – vecorite e ndryshme te sigurise garantohen nga cdo grup perdorues. Per shembull, kodi i fshehte SICPADATA® eshte i pershtatshem vetem per inspektoret. Trajnimi eshte keshtu i percaktuar per cdo grup me nivele te ndryshme fokusi dhe qendrimi. Procesi i trajnimit te cdo grapi ka per qellim te garantoje drejtimin e qarte te pjesemarresve se si te garantojne konsistencen duke pare dhe kontrolluar zgjidhjen e sigurise fushen dhe zinxhirin e shperndarjes.

2. Metoda e trajnimit

Metodologjia jone eshte kryesisht e orientuar ne drejtimin trajno – trajnuesin. Kjo metodologji i ka mundesuar perdoruesve dhe operatoreve qe shume shpejt te behen te pavarur dhe eficent ne kete fushe.

Me poshte eshte nje pershkrim i trajnimit per pozicionimin e zgjidhjes SICPATRACE®.

3. Pergjegjesia e trajnimit

Menaxheri i sherbimit ndaj klientit eshte pergjegjes per permbajtjen, trajnuesit, dhe programimin e trajnimeve. Eshte nen pergjegjesine e tij te garantoje se te gjithe perdoruesit dhe operatoret jane trajnuar sipas nevojave te tyre.

4. Trajnimi ne vend dhe gjuha

Te gjitha programet trajnuese do te pergetiten dhe zhvillohen per tu dorezuar ne gjuhen shqipe ne ambjentet e qeverise, ne zyrat e SICPA dhe ne ambjentet perkatese te prodhimit ne Shqiperi.

5. Frekuencia

Duke ndjekur trajnimin gjate pozicionimit te SICPATRACE®, rishikimet e trajnimit do te organizohen ne baze periodike ose kurdohere qe eshte nevoja per nje trajnim – kursi rifreskues.

6. Materiali

Te gjitha materialet e perdorura ne kurse do ti dorezohen perdoruesit ne gjuhen shqipe.

7. Trajnim specifik per Inspektoret dhe Nepunesit e Qeverise

Sic u permend, qellimi i trajnimit do te pershtatet per grupin e perdoruesve.

Per Inspektoret dhe nepunesit e qeverise, SICPA do te mbaje sesione trajnimi si pjese e lancimit te zgjidhes se re SICPATRACE® . Ky trajnim do te behet ne ambjentet e qeverise.

Programi trajnues per inspektoret dhe nepunesit e qeverise do te perfshije tete module:

- Te gjithe pullat SICPATRACE® dhe diznjimin e kodimit, karakteristikat dhe funksionet
- Karakteristikat autentike te dukshme
- Lexuesin SICPAMOBILE®
- Funksionet SICPAMOBILE®
- Gjurmen qendrore dhe Sistemin e Monitorimit te Gjurmës dhe web serverin me Gjurmen Qendrore si dhe funksionet e Sistemit te Monitorimit te Gjurmës dhe raportimin menaxhues.
- Komunikimi SICPAMOBILE® me Gjurmen Qendrore dhe Sistemin e Monitorimit te Gjurmës
- Veshtrim i pergjithshem i Qendres Koduese te Personalizuar (QKP)
- Veshtrim i pergjithshem te Sistemit te Aktivizimit dhe Skanimit (SVS)
- Veshtrim i pergjithshem i Linjes se Kodimit te Sigurte (LKS)

Se bashku me trajnimin ne thellesi, punonjesit inspektor do te pajisen me manuale qe perfshijne te gjithe komponentet e programit sic u nenvizua me siper.

Te gjitha pullat dhe dizenjimi i kodimit, karakteristikat e sigurise dhe funksionet do tu behen te njohura pjesemarresve. Ai do tu shpjegoje se si te shohin karakteristikat e dukshme, gjysem te dukshme dhe te fshehura.

Lexuesi SICPAMOBILE® i jep mundesine inspektoreve te lexojne dhe te deshifrojne kodet e SICPADATA® ne rastet kur pullat jane te padukshme per syrin njerezor.



Figura 1: lexuesi SICPAMOBILE®

Gjate trajnimit te Gjurmës Qendrore dhe Sistemit/web server Monitorues te Gjurmës, instruktoret do te shpjegojne dhe do te njojin vizualisht nepunesit e qeverise me procedurat automatike te berjes se porosise, hyrjes, raportimit dhe ndjekjes se kodeve perkatese SICPADATA®.

8. Trajnimi per Sistemin e Aktivizimit dhe Skanimit (SAS) dhe Sistemin e Linje se Kodimit te Sigurise (LKS) per Ekipet e Instalimit dhe te Mirembajtjes

Programi trajnues SAS dhe LKS eshte percaktuar per ekipet e instalimit dhe te mirembajtjes (punonjesit SICPA). Programi trajnues SAS dhe LKS perfshin pese module:

- Veshtrim i pergjithshem i pajisjeve SAS dhe LKS
- Funksionimin e pajisjeve SAS dhe LKS (te dyja klasen dhe zhvillimin e trajnimit)
- Identifikimin e problemit dhe rregullimin e difekteve
- Veshtrim i Pergjithshem i karakteristikave siguruese te pullave te reja
- Informacionin SAS dhe LKS te derguar Sistemit te Monitorimit te Gjurmës dhe Gjurmës Qendrore

9. Trajnimi per Sistemin e Aktivizimit dhe Skanimit (SAS) dhe Linjen e Kodimit te Sigurise (LKS) Sistemi per Operatoret e Linjave prodhuese

Programi trajnues SAS dhe LKS eshte percaktuar per operatoret e prodhuesve te duhanit, alkolit dhe birres ne vendet e prodhuesit.

Programi trajnues SAS dhe LKS perfshin tre module:

- Veshtrimi i per gjithshem i pajisjeve SAS dhe LKS
- Funksionimin e pajisjes SAS dhe LKS (te dyja klasat dhe zhvillimin e trajnimit)
- Identifikimi i problemit dhe rregullimin e difekteve

Ky trajnim do te behet ne vendet e prodhimit dhe bazohet ne drejtimin trajno – trajnuesin.

Aneksi 18 – Cmimi, Tarifat dhe Kostot

1. Cmimi

Cmimet jane parashtruar ne Nenin 17 te kesaj Marreveshje.

2. Tarifa e Koncesionit

- 2.1 Koncesioneri do t'i paguaje Autoritetit nje Tarife Koncesioni prej dy perqind (2%) te Te Ardhurave Neto nga shitja e pullave fiskale per te drejtat dhe privilegjet e akorduara ne kete Marreveshje, sipas pasqyrave financiare te audituara te Kompanise se Koncesionit per cdo Vit Financiar.
- 2.2 Tarifa vjetore e Koncesionit ne lidhje me cdo Vit te Marreveshes do te paguhet nga Koncesioneri per Autoritetin jo me vone se kater muaj pas dates se fundit te ketij Viti te Marrveshjes bazuar ne pasqyrat financiare per kete Vit Marreveshje.

3. Kostot

- 3.1 Pervecse kur parashikohet ndryshe ne kete Marreveshje ose diku tjeter, seicila Pale do te paguaje direct ose ne menyre te terthorte kostot e veta per komunikimin, negicimin, perqatitjen dhe zbatimin e kesaj Marrevshje.
- 3.2 Per cdo rishikim ne lidhje me alokimin e kostove dhe shpenzimeve te Koncesionit do te bihet dakord paraprakisht me shkrim midis Paleve ne perputhje me Proceduren e Ndryshimit te Kontrollit.
- 3.3 Palet Kryesore do te takohen dhe do te diskutojne cdo ndryshim per shperndarjen e kostove dhe shpenzimeve sipas kesaj Marreveshje brenda pesembedhjete (15) ditesh nga data e marrjes se nje kerkese me shkrim nga seicila Pale Kryesore. Koncesioneri nuk do te jete I detyruar te beje shpenzime shtese ne lidhje me modifikimet e nevojshme per te qene ne perputhje me standartet nderkombetare pas Dates se Hyrjes ne Fuqi pervecse kur per keto kosto eshte rene dakort ne perputhje me Proceduren e Ndryshimit te Kontrollit.

Anekzi 19 – Drejtimi

1. Hyrje

Anekzi përkruan procedurat qe do te perdoren per te menaxhuar marredheniet midis Autoritetit dhe Koncessionerit sipas kesaj Marreveshje.

2. Krijimi i Bordit te Menaxhimit te Projektit

- 2.1 Bordi i Menaxhimit te Projektit do te ngrihet nga Autoriteti sipas kesaj Marreveshje dhe ku do te perfaqeshen si Koncessioneri dhe Autoriteti .
- 2.2 Koncessioneri dhe Autoriteti do te emerojne seicili nga një Menaxher Projekt.
- 2.3 Koncesioni do te menaxhohet ne nivel e perditshem nepermjet Menaxherit te Projektit te Koncessionerit dhe Menaxherit te Projektit te Autoritetit, ne perputhje me Planin e Zbatimit.
- 2.4 Bordi i Menaxhimit te Projektit do te jetë pergjegjes per drejtimin ekzekutiv te Koncessionit sic eshte percaktuar ne kete Marreveshje. Roli dhe funksioni i Bordit te Menaxhimit te Projektit eshte percaktuar me ne detaje ne Paragrafin 4 me poshte.
- 2.5 Bordi i Menaxhimit te Projektit do te:
 - 2.5.1 jape/percaktoje udhezime te nivelist te larte, lidership dhe strategji per Koncessionin;
 - 2.5.2 te jetë pika e përkallezimit nga Menaxheri i Projektit te Autoritetit dhe menaxherit te per gjithshem te SICPA Albania; dhe
 - 2.5.3 te zbatuje detyrimet specifike qe i jane atribuar ne kete Marrevshje.
- 2.6 Te dy Plalet do te garantojne se burimet e duhura Jane vene ne dispozicion vazhdimesht ne menyre qe qellimet, objektivat dhe dispozitat specifike te kesaj Marreveshje te mund te realizohen plotesisht.

3. Struktura e Bordit te Menaxhimit te Projektit & Perfaqesimi

- 3.1 Shtojca e ketij Anekzi përkruan lidhur me Bordin e Menaxhimit te Projektit:
 - 3.1.1 rolet dhe per gjegjesite e Bordit te Menaxhimit te Projektit,

- 3.1.2 sa shpesh do te mblidhet Bordi i Menaxhimit te Projektit (pervecse kur bihet dakort ndryshe midis Paleve);
 - 3.1.3 vendndodhja ku do te mbahen mbledhjet e Bordit te Menaxhimit te Projektit; dhe
 - 3.1.4 data e planifikuar kur do te ngrihet Bordi i Menaxhimit te Projektit .
- 3.2 Ne rast se ndonjera nga Palet deshiron te zevendesoje ndonje pozicion te Anetarit te BMP , atehere ajo Pale do te njoftoje tjetren me shkrim per ndryshimin e propozuar per miratim nga Pala tjeter(ky miratim nuk do te pengohet ose vonohet pa arsy). Pavaresisht sa me siper, synohet qe cdo per cdo Anetar te BMP te Autoritetit te kete respektivisht nje koleg Anetar te BMP te Koncesionerit me te njejtin eksperience dhe nivel ekspertize.
- 3.3 Seicila pale do te garantoje se Anetaret e saj te BMP do te bejne te gjitha perpjekjet e arsyeshme per te marre pjese ne mbledhjet e Bordit te Menaxhimit te Projektit kur kerkohet pjesemarrja e Anetarit te BMP . Nese ndonje Anetar i BMP nuk eshte ne gjendje te marre pjese ne mbledhjen e Bordit te Menaxhimit te Projektit, atehere ai person do te beje te gjitha perpjekjet e arsyeshme per te garantuar se:
- 3.3.1 nje delegat te marre pjese ne mbledhjen perkatese te Bordit te Menaxhimit te Projektit ne vend te tij/saj, i cili (kur eshte e mundur) te jete i perqatitur per kete pjesemarrje ; dhe
 - 3.3.2 ai/ajo te informohet nga ky delegat pas mbledhjes se Bordit te Menaxhimit te Projektit.
- 3.4 Nje kryetar do te emerohet nga Autoriteti per mbledhjet e Bordit te Menaxhimit te Projektit sic jane identifikuar ne Shtojcen e ketij Aneksi. Kryetari do te kete pergjegjes per:
- 3.4.1 programimin e Mbledhjeve te Menaxhimit te Projektit;
 - 3.4.2 percaktimin e rendit te dites per mbledhjet e Bordit te Menaxhimit te Projektit dhe shperndarja e ketij tek te gjitha pjesemarresit paraprakisht ;
 - 3.4.3 kryesimi i mbledhjeve te Bordit te Menaxhimit te Projektit;
 - 3.4.4 monitorimi i progresit i cdo detyre dhe aktiviteti per te cilat eshte rene dakord qe do te zbatohet ne vijim te mbledhjeve te Bordit te Menaxhimit te Projektit ;
 - 3.4.5 te garantoje se procesverbalet per Bordin e Menaxhimit te Projektit te registrohen dhe shperndehen elektronikisht tek personat e duhur dhe tek te gjithe pjesemarresit e

mbledhjes se Bordit te Menaxhimit te Projektit brenda shtate (7) Dite Pune pas mbledhjes se Bordit te Menaxhimit te Projektit ; dhe

- 3.4.6 te mundesoje procesin ose proceduren me anen e se ciles cdo vendimi te miratuar nga Bordi i Menaxhimit te Projektit t'i jepet fuqi ligjore ne menyren e duhur.
- 3.5 Mbledhjet e Bordit te Menaxhimit te Projektit do te jene me kuorum per sa kohe qe te pakten dy (2) perfaquesues nga seicila Pale jane te pranishem.
